



RAPORT MONITORIMI JANAR – SHTATOR 2019

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË

www.drejtesia.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

I. Përmbledhje ekzekutive mbi monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të Veprimit 2019 – 2021, për periudhën Janar – Shtator 2019.....	4
a. Përmbledhje ekzekutive mbi reformën e sistemit të drejtësisë	7
II. Metodologjia e monitorimit	20
III. Disbursimi financiar.....	21
IV. Progresi i zbatimit sipas objektivave	22
Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.....	22
Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.....	23
Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.....	25
Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.....	26
Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.....	27
Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.....	28
Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.....	29
Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.....	30
V. Arritjet kryesore gjatë periudhës Janar – Shtator 2019.....	31
VI. Konkluzione.....	35
VII.Sfidat	36
Aneks 1 – Progresi lidhur me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi	37
Aneks 2 – Plani i Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë	39

LISTA E SHKURTIMEVE

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASHSGJ	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
DHKNd	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterëve
DHKPGJP	Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Gjyqësor Privat
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SPAK	Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHKBB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve
SHP	Shërbimi i Provës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2019 – 2021, PËR PERIUdhËN JANAR - SHTATOR 2019.

Reforma në Drejtësi ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj. Disa prej institucioneve të reja janë ngritur dhe të tjera janë në pritje për t'u ngritur së shpejti. Përsa i përket institucioneve të cilat operojnë në sistemin e drejtësisë, ato janë angazhuar plotësisht, me qëllim për të pasur një sistem drejtësie në përputhje me standardet që një vend në pritje të hapjes së negociatave me vendet anëtare të Bashkimit Evropian duhet të ketë dhe duhet të realizojë.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 773, datë 2.11.2016, ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e saj të Veprimit. **Misioni** i kësaj strategjie është zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Ky dokument përmban *tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë*, të cilat janë:

1. Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
2. Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.
3. Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
4. Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
5. Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
6. Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.
7. Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë.
8. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Përsa më sipër, në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e Planit të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën 2019 - 2021. Për këtë qëllim, u hartua Pasaporta e Indikatorëve, në funksion të objektivave të strategjisë. Në muajin qershor, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 409, datë 19.06.2019 ka miratuar Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Metodologjia e ndjekur në rishikimin e Planit të Veprimit ishte përfshirja e të gjithë institucioneve përgjegjëse, të identifikuar në Planin e Veprimit të mëparshëm, marrja e kontributeve dhe parashikimeve të tyre direkte në hartim dhe zbatim të masave. Masat e parashikuara janë ideuar mbi bazë rezultati konkret, të matshëm dhe janë të kostuara. Gjatë parashikimit të masave u aplikua ndërlidhja **objektiv-indikator-masë**. Objektivat e Strategjisë janë organizuar dhe ndarë në nën-objektiva për të bërë të mundur një organizim më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë të masave të

parashikuara dhe të lidhura me to. Është aplikuar formati i parashikimit të masave me target/milestones.

Masat e reja të Planit të Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë synojnë të intensifikojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të reja në drejtësi, si KLGJ, KLP, ILD, KED, të SPAK e Gjykatës së Posaçme (GJKKKO), të thellojnë formimin tekniko-profesional të sistemit të drejtësisë nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve e administratës gjyqësore apo dhe rritjen e aksesit në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të Ndhmës Juridike Falas.

Plani i Veprimit 2019-2021, i jep një hov zhvillimi përmirësimit të gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe të tjera përmirësime në infrastrukturë. Organet e reja në drejtësi parashikohen të jenë më mirë të pajisura me kushte dhe mjete pune funksionale.

Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë, pjesë e Planit të Veprimit 2019-2021, vijnë me masa konkrete në drejtim të zhvillimit strukturor, organizativ dhe thellim kapacitetesh njerëzore e profesionale për të bërë të mundur detyrimet që vijnë nga Strategjia.

Profesionet e lira ligjore janë bërë pjesë e Planit të Veprimit 2019-2021, me masa të parashikuara për t'u përmbushur dhe që vijnë si produkt i ndryshimeve ligjore që ligjet e tyre pësuan në kuadër të Reformës në Drejtësi.


Plani i Veprimit 2019- 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, konsiston në:

- ✓ 8 objektiva strategjike;
- ✓ 11 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve;
- ✓ 7 indikatorë transhi të Bashkimit Evropian;
- ✓ 65 masa.


Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SND-së. Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 dhe mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar – 30 shtator 2019.

Plani i Veprimit përbëhet nga 8 objektivat e mësipërme dhe përmban në total 65 masa. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të masave të SND bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë muajit tetor 2019. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për periudhën janar - shtator 2019, rezulton se niveli i zbatimit të masave të Planit të Veprimit është si më poshtë:

Statusi i zbatimit të masave sipas Objektivave



Progresi total i masave të PV 2019 – 2021



Për periudhën janar – shtator 2019 nga 65 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2019 – 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë realizuar 13 prej tyre, 39 janë ende në proces zbatimi, 5 masa janë të porealizuara, si dhe 8 masa të paraportuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 është në nivelin 20% për masat të cilat janë të realizuara, 60% për masat në proces, 8% për masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse, si dhe 12% masat të paraportuara.

a. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI REFORMËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

o Progresi në Legjislacion

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri i është nënshtruar së fundmi një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standarteve evropiane në këtë sistem. Përmes miratimit të Ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, Shqipëria krijoi bazën për zbatimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e reformës së drejtësisë përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj. *Për më tepër, një paketë ligjesh është miratuar, duke mbuluar të gjitha aspektet e reformës gjyqësore, ku Kuvendi ka miratuar 22 ligje, si dhe një vendim, duke përmblytur kështu paketën e ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë¹.*

Në muajin dhjetor 2018, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 110/2018 “Për Noterinë”². Ligji përcakton rregullat për ushtrimin e profesionit të noterit, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të noterisë në Republikën e Shqipërisë. Për më tepër, ligji përcakton dhe procedurat për provimin e pranimit në formimin fillestar, krijimin e pozicionit të zëvendësnoterit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së zëvendësnoterëve, mbikqyrjen dhe përgjegjësinë disiplinore, kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat, financimin e veprimtarisë noteriale, organizimin dhe funksionimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë etj.

Në muajin prill 2019, Kuvendi miratoi Vendimin Nr. 47/2019, datë 18.04.2019 “Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 – 2023”. Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) përcakton vizionin, objektivat strategjike dhe specifike të edukimit ligjor të publikut (ELP) përgjatë periudhës 2019-2023. SELP është dokumenti i parë strategjik i miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve. Vizioni i ELP për vitet e ardhshme është: *Qytetarë më të ndërgjegjësuar për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.*

Në muajin prill 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Ky ligj përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me: a) organizimin dhe funksionimin e shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore; b) veprimtarinë e tyre hetimore; c) statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore; ç) raportet me prokurorinë dhe me institucionet shtetërore ku bëjnë pjesë.

Në muajin maj 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”³. Ky ligj ka si objekt përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Privat, kushtet që duhet të përmbushin individët

1 Më tepër informacion mbi paketën e ligjeve të reformës në drejtësi është pasqyruar në aneksin 1 të këtij raporti.

2 Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 16, dt. 13 shkurt 2019. Më datë 07.02.2019, me Vendimin Nr. 29/2019 është rrëzuar Dekreti Nr. 11 054, Datë 14.1.2019, të Presidentit të Republikës, “Për Kthimin e ligjit Nr. 110/2018 ‘Për Noterinë’”.

3 Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 99, dt. 10 korrik 2019. Më datë 04.07.2019, me Vendimin Nr. 74/2019 është rrëzuar Dekreti Nr. 11 195, Datë 31.05.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit Nr. 26/2019 ‘Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat’”.

për të ushtruar detyrën e përmbaruesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, rregullat e caktimit të tarifave, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

○ Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë

Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit shqiptar. Institucionet e reja janë krijuar nga amendamentet kushtetuese dhe ligjet specifike organike të lartpërmendura.

Ministria e Drejtësisë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” nuk ushtron më kompetencën e kontrollit të veprimtarisë së prokurorive dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe të dhënies së rekomandimeve për procedim disiplinor në rastin e prokurorëve dhe procedimin disiplinor në rastin e gjyqtarëve. Nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çdo ankesë apo informacion, që nga verifikimi paraprak kur rezulton se ka indicie të besueshme për shkelje disiplinore nga ana e magjistratit, i përcillet për verifikim dhe ndjekje të mëtejshme të procedurave ILD-së.

Institucionet e krijuara rishtazi dhe ato që parashikohen të ngrihen janë si në vijim:

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016⁴.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016⁵.
- Njësia e Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016.
- Gjykata kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – Kushtetuta dhe Ligji nr. 98/2016.
- Këshillat e Gjykatave – Ligji nr. 98/2016⁶.
- Institucionet Ri-vlerësuese – Ligji nr. 84/2016⁷.

Për më tepër, në muajin korrik 2019, u miratua Ligji nr. 47/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”⁸, si dhe Ligji nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁹. Rishikimi i këtyre dy ligjeve, ndër më kryesorët të reformës në drejtësi, erdhi për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2017, të cilat shfuqizuan dispozita të caktuara në këto ligje.

⁴ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_nr_115_2016_per_organet_e_qeverisjes_se_sistemit_te_drejtësisë_1726.pdf

⁵ <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/10/ligji-nr-95-dt-6-10-2016.pdf>

⁶ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/209-2016.pdf

⁷ <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/VETINGU/ligj-nr-84-dt-30-8-2016.pdf>

⁸ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/113/837b2b34-2833-4add-8635-994462b57cc5>

⁹ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/116/cefba541-edd9-4c6a-9832-ca386de2677b>

Vakumi ligjor i krijuar nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese (Nr. 41/2017, Nr. 78/2017 dhe Nr. 34/2017¹⁰) krijonte problem për zbatimin rigoroz të ligjeve të reformës, veçanërisht lidhur me funksionin apo procesin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Dy ligjet e mësipërme plotësojnë vakumin e krijuar, duke bërë të mundur zbatimin e kuadrit ligjor të paketës në reformën e sistemit të drejtësisë.

Përsa i përket institucioneve të krijuara rishtazi, **një hap vendimtar në zbatimin e reformës në drejtësi shënoi ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilat janë 2 shtyllat për një sistem gjyqësor të pavarur dhe cilësor.**

Në mbështetje të institucioneve të reja që janë ngritur në kuadër të reformës në drejtësi, më datë **22 korrik 2019**, është inaguruar godina “**Poli i Drejtësisë**”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.234, dt.17.04.2019¹¹. “Poli i Drejtësisë” grupon dhe akomodon institucionet e drejtësisë si: Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Shkollën e Magjistraturës, në një zonë të vetme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe parashikimet e nenit 277, pika 3, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me besimin dhe angazhimin e plotë se do të sigurojë një sistem gjyqësor të drejtë, i cili mbështetet në parimet e pavarësisë, llogaridhënies, transparencës dhe të eficiencës, në mbledhjen e datës 20.12.2018, me vendimin nr. 4 u krijua Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Që nga krijimi i KLGJ dhe deri më 30.09.2019, janë marrë 202 vendime, të cilat kanë pasur në fokus:

- i. rregullimin e veprimtarisë së KLGJ-së;
- ii. mirë administrimin e gjykatave nëpërmjet rregulloreve të ndryshme si: skema e delegimit, transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin në çështje të veçanta në gjykata të tjera, zgjedhja e zëvendëskryetarëve të gjykatave etj.
- iii. statusin e gjyqtarëve duke përfshirë procesin e emërimit të magjistratëve të rinj, nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nisjen e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve jo gjyqtarë të Gjykatës së Lartë etj.

KLJGJ duke marrë në konsideratë problematikat që shfaq sistemi i drejtësisë, ndërmori hapat e nevojshme për adresimin dhe zgjidhjen e tyre. Pas zgjedhjes së organeve drejtuese, të kryetarit dhe të zëvendëskryetarit, si dhe të anëtarëve të cilët do të ushtrorjnë detyrën me mandat 3/5-vjeçar, KLGJ ka miratuar një numër vendimesh të karakterit rregullator, si dhe vendime të cilat kanë të bëjnë me ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme dhe të komisioneve të përkohshme. *Ngritja e komisioneve të përhershme dhe komisioneve të përkohshme është një domosdoshmëri për të shqyrtuar çështje të veçanta.*

¹⁰ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹¹ <https://qzb.gov.al/eli/fz/2019/55/ff19db48-0410-43a6-b795-9a68345718fe;q=55>

Konkretisht, KLGJ ka përfunduar ose është në proces të përfundimit të prioriteteve të mëposhtme:

Struktura e KLGJ-së dhe organigrama administrative është miratuar me vendimin nr. 80 datë 30.05.2019. Hartimi i përshkrimeve të punës është në përfundim, vlerësimi i të gjithë punonjësve (nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativ të KLGJ-së dhe ZABGJ-së) ka përfunduar në qershor 2019 dhe hapja e vendeve të lira për nëpunësit civil dhe punonjës të tjerë administrativë për plotësimin e strukturës është në proces.

Rregullat dhe aktivitetet në lidhje me magistratë si përgjigje ndaj mungesës së gjyqtarëve, numrin e çështjeve të mbartura dhe procedimeve të zakonshme të gjykatave në nevojë.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (Komision i Përhershëm) ka përfunduar rregullat e funksionimit (vendimi nr. 22 dhe 23, datë 7.02.2019) si më poshtë:

- Rregullat për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magistratëve dhe periudha e shërbimit sipas skemës së lëvizshmërisë;
- Rregullat për njoftimet dhe metodat për mbushjen e vendeve vakante të përkohshme (të krijuara nga komandimet, transferimet, promovimet etj.);
- Nisja dhe organizimi i një transferimi paralel për magistratët;
- Rregullat për kriteret dhe procedurën për promovimin e magistratëve në nivele më të larta (Gjykatat e Apelit, GJL, GJK, ILD, Gjykatat e Juridiksionit të Posaçëm).

Aktivitetet (delegimet/transferimet) janë një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, i cili ndiqet nga KLGJ si më poshtë:

- Caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kur ligji parashikonte një afat dyjavor nga krijimi i KLGJ-së; Transferimi i kompetencës së Gjykatës së Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda të Apelit; Nisja e procedurës për emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Anti-Korrupsion dhe Krimit të Organizuar. Dërgimi i formularëve të deklarimit për t'u plotësuar nga gjyqtarët në detyrë, ku jepet autorizimi për zbardhjen e llogarive financiare dhe telekomunikimeve personale (shkalla e parë dhe e dytë) ka përfunduar në muajin Janar 2019. Në shkurt 2019 ka përfunduar mbledhja e deklaratave, ndërsa realizimi i verifikimeve për emërimin e gjyqtarëve në gjykatat e zakonshme, ose promovimi i gjyqtarëve në gjykatat e specializuara është në proces nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Përsa i përket nisjes së procesit të emërimit dhe caktimi në detyrë i magistratëve të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magistraturës në vitin 2018 dhe pranimet e reja në SHM, vlerësimi dhe përcaktimi i vendeve të lira për t'u plotësuar menjëherë nga magistratët e diplomuar ka përfunduar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Kontrolli i pasurisë dhe i së shkuarës së kandidatëve magistratë është përfunduar nga ky komision në korrik 2019, si dhe është miratuar nga KLGJ me vendimet 117-125, datë 15.07.2019. Emërimi i kandidatëve magistratë të diplomuar në Shkollën e Magistraturës në vitin 2018 si gjyqtarë ka përfunduar me vendimet nr. 127-136, datë 19.07.2019, ndërsa caktimi i magistratëve në detyrë ka përfunduar me vendimet nr. 145-154, datë 30/07/2019.

Përcaktimi dhe publikimi i numrit të kandidatëve magistratë për t'u pranuar në trajnimin fillestar për vitin e ardhshëm akademik ka përfunduar me Vendimin nr. 17, datë 29.01.19, si dhe KLGJ

është shprehur me komentet, të cilat i jepen SHM, pas vlerësimit paraprak të aplikimeve nga Shkolla e Magjistraturës për t'u pranuar në trajnimin fillestar, me relacionin e datës 28 Mars 2019 “*Komentet dhe kundërshtimet e raportit të Shkollës së Magjistraturës me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2019-2020, profili gjyqtar*”. Me Vendimet 183 – 202, datë 02/10/2019, KLGJ ka miratuar përmbushjen e kriterëve ligjore dhe profesionale të pranimit në Shkollën e Magjistraturës për **20 kandidatë**, për vitin akademik 2019 – 2020.

Rekrutimi dhe emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë: Rregullat për kriteret dhe procedurën për promovimin e magjistratëve në Gjykatën e Lartë ka përfunduar. Miratimi i rregullave për kriteret dhe procedurën për emërimin e jo gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë ka përfunduar. Shpallja e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur është publikuar më datë 10.07.2019. KLGJ tashmë ka hapur thirrjen për kuotën e 1/5 ose 4 vendeve në Gjykatën e Lartë dhe aktualisht po shqyrton aplikimet, si dhe po përfundon procedurat e nevojshme për verifikimin e integritetit të kandidatëve, aftësive profesionale dhe pasurisë. Së shpejti pritet që të paktën 4 gjyqtarë të ardhur nga juristë të shquar (jo-gjyqtarë) të emërohen dhe të formojnë një trup gjykues funksional në Gjykatën e Lartë.

Përsa i përket *mbështetjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit* nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, KLGJ vazhdon të jetë e angazhuar intensivisht në mbështetjen e procesit të veting-ut, kryesisht me hartimin e raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Deri më datë 30 shtator 2019, janë përgatitur dhe dorëzuar pranë KPK dhe ONM **196 raporte vlerësimi**.

Gjithashtu, në muajin korrik 2019, me Vendimin Nr. 126, dt. 19.07.2019, KLGJ ka përfunduar dhe miratuar *Planifikimin Strategjik* dhe Planin e Veprimit.

KLGJ është në proces të *përcaktimit të juridiksionit territorial dhe përmasave të gjykatave*. Grupi i ndërinstitucional i punës, (i përbërë nga përfaqësues nga gjykatat e vendit, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si: Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të Gjithë” - JUST/USAID), bazuar në metodologji dhe standarde ndërkombëtare, pas një analize paraprake, ka në përfundim tre draft – opsionet e para të hartës së re gjyqësore.

Verifikimi i kriterëve ligjore për kancelarët në detyrë: Në përmbushje të këtij detyrimi KLGJ ka filluar procesin e verifikimit paraprak të të gjithë kancelarëve në detyrë, 37 kancelarë. Ndërkohë që KLGJ në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe mbështetjen e Projektit “Drejtësi për të Gjithë” (USAID) në muajt qershor – korrik 2019 organizoi një program trajnimi për të gjithë kancelarët e gjykatave mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të administrimit gjyqësor.

Krijimi dhe administrimi i dosjeve personale dhe i regjistrit të magjistratëve: Krijimi i sistemit në bashkëpunim me JFA dhe EURALIUS përfundoi me Vendimin Nr.114 datë 9.07.2019 “Mbi krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve”. Sistemi është funksional.

KLP është një nga institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i cili u krijua në kuadër të reformës në drejtësi, pas ndryshimeve në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe miratimit të ligjeve të posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve që përbëjnë sistemin e drejtësisë.

Neni 149, i Kushtetutës parashikon se KLP është organ kolegjial i përbërë nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 anëtarë zgjidhen nga radhët e prokurorëve të të gjitha niveleve dhe 5 anëtarë zgjidhen nga Kuvendi midis radhëve të juristëve. Përkatësisht, më datë 11 dhjetor 2018, u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e gjashtë anëtarëve prokurorë të KLP, ndërsa takimi i parë i KLP u mbajt më datë 19 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.

KLP garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, në këtë strategji do të raportohen disa prej çështjeve më të rëndësishme, në fokus kombëtar e ndërkombëtar, sikurse është ngritja e Prokurorisë së Posaçme (më tej, SPAK), procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, apo edhe aspekte të tjerë si: hartimi i akteve nënligjore, zgjedhja e drejtuesit të SPAK dhe e ardhmja e Byrosë Kombëtare të Hetimit (më tej, BKH).

o *Mbi procedurën e krijimit të SPAK*

KLP është autoriteti kompetent për emërimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në nenin 179/8 të Kushtetutës, nenin 4/2 të ligjit “Për statusin e organizimit dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (më tej, Ligji për SPAK) dhe nenin 48/2 dhe 3 të ligjit “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KLP, më datë 7 janar 2019, njoftoi fillimin e procedurave për plotësimin e 15 pozicioneve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në fund të afatit, më 21 shkurt 2019, 28 kandidatë kanë aplikuar, ku vetëm 25 prej tyre plotësuan kushtet ligjore për të vazhduar garën për prokurorë të posaçëm.

Njëkohësisht me shpalljen e vendeve vakante, nisi puna për hartimin e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” (më tej, Rregullorja). Procesi i hartimit të Rregullores është mbështetur nga ekspertët e OPDAT dhe EURALIUS. Rregullorja është miratuar me Vendim nr. 51, datë 19.03.2019, të KLP-së dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 29.03.2019. Në të njëjtën datë, rregullorja ka hyrë në fuqi.

Numri i kandidatëve për prokuror të posaçëm arriti në 24, si rezultat i dorëheqjes nga konkurrimi dhe zgjedhjes anëtar në KLP të prokurorit Z. Vatë Staka.

Gjithashtu, Z. Shkëlzen Cena, më datë 27.5.2019, paraqiti kërkesën për dorëheqje nga procesi i vlerësimit për prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme, regjistruar me nr. 462 Prot., dhe Këshilli me Vendim nr. 57/1, datë 12.6.2019, vendosi ndërprerjen e garës për këtë kandidat.

Ndërsa Z. Eugen Beçi është shkarkuar nga detyra nga KPK-ja më datë 26.06.2019. Deri në përfundim të vlerësimit të këtij subjekti, ai konsiderohet i pezulluar dhe nuk vijon të ushtrojë

detyrën e prokurorit. Për këtë shkak, KLP me vendim nr.118, datë 28.6.2019, ka vendosur pezullimin e garës për këtë kandidat.

KLP ngriti një Komision të Posaçëm, i cili vendosi një komunikim zyrtar me kandidatët.

Pas dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar nga kandidatët, Komisioni i Posaçëm filloi punën për vlerësimin e tyre. Me Urdhër të Kryetarit të Komisionit të Posaçëm u miratua metodologjia e punës së tij.

Në periudhën maj-qershor 2019, Komisioni ka zhvilluar një veprimtari intensive për vlerësimin e kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme. Në këto takime kanë qënë prezent përfaqësuesit e OPDAT dhe EURALIUS.

Pas një pune intensive dhe diskutimeve të gjata, Komisioni ka bërë vlerësimin lidhur me kualifikimin e kandidatëve sipas kriterëve të parashikuara Rregullore.

Nga 22 kandidatët në garë për prokurorë, pas procesit të intervistimit të zhvilluar gjatë muajit korrik 2019, u përzgjedhën **15 kandidatët për prokurorë** pranë SPAK. KLP, me Vendimin nr. 137, datë 16.07.2019, miratoi listën me renditjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar¹².

KLP është në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme për të vijuar më tej, me ngritjen e Prokurorisë së Posaçme dhe emërimin e prokurorëve të kësaj prokurorie. Aktualisht 8 (tetë) prokurorë janë konfirmuar me vendim të formës së prerë, dy të tjerë janë ankimuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, ndërsa pesë të tjerë nuk i janë nënshtruar ende procesit të rivlerësimit.

o *Për procedurën e përzgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm*

Përsa i përket pozicionit të Prokurorit të Përgjithshëm, KLP është organi përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve për këtë pozicion. Në këtë kuadër, me Vendimin nr. 50, datë 19.03.2019, Këshilli miratoi rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”. Prosesi i hartimit të Rregullores është mbështetur nga ekspertët e misionëve OPDAT dhe EURALIUS. Më tej, KLP shpalli ftesën për paraqitjen e shprehjeve të interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Përsa më sipër, në mbyllje të afatit të vendosur nga KLP (datë 29.04.2019) shprehën interes për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm 4 kandidatë (Znj. Arta Marku, Znj. Fatjona Memçaj, Z. Lulzim Alushaj dhe Z. Olsian Çela).

Brenda 45 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjes së interesit nga kandidatët, KLP duhet të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas legjislacionit në fuqi. Ndërkohë po në zbatim të dispozitave ligjore, KLP pret dhe përfundimin e procedurave të rivlerësimit për kandidatët që i nënshtrohen këtij procesi deri në konfirmimin e tyre. KLP i është drejtuar zyrtarisht Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për të mundësuar rivlerësimin me përparësi të kandidatit Z. Olsian Çela, në mënyrë që procesi të përfundonte brenda afatit ligjor.

¹² <http://klp.al/wp-content/uploads/2019/07/Nr.137-Dat%C3%AB-16.07.2019.pdf>

KLP, me Vendimin nr. 109, datë 17.06.2019, vendosi të shtyjë afatin 45 ditor për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët në garë, deri në përfundimin e këtij procesi për kandidatin Z. Olsian Çela.

Në mbledhjen e KLP, më 25.09.2019, me marrjen e vendimit përfundimtar të konfirmimit në detyrë të kandidatit z. Olsian Çela nga organet e vetëqeveritjes, u miratua lista përfundimtare me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet për të vijuar garën për Prokuror të Përgjithshëm, si më poshtë:

- Znj. Arta Marku;
- Z. Olsian Çela;
- Znj. Fatjona Memçaj.

Të tre kandidatët rezultojnë se i plotësojnë kushtet për të vijuar garën më tej, ndërkohë që një kandidati iu ndalua vijimi i kandidimit (Z. Lulzim Alushaj), pasi nuk plotësoi kushtin 15 vjet përvojë pune si jurist i spikatur, si dhe kishte mungesë dokumentacioni (dy vetëdeklarime). Me vendimin nr. 169, datë 25.09.2019, KLP vendosi ndalimin e kandidimit të kandidatit për Prokuror të Përgjithshëm¹³.

o *Akte të miratuara për periudhën e raportimit*

Gjatë periudhës janar – shtator 2019, KLP ka miratuar aktet si më poshtë vijon:

- ✓ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.
- ✓ Rregullore “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”.
- ✓ Metodologjinë e punës së Komisionit të Posaçëm për Vlerësimin e Kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- ✓ Rregullore “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”.
- ✓ Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”.
- ✓ Rregullore “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”.
- ✓ Rregullore “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”.
- ✓ Rregullore “Për vlerësimin etik dhe profesional të subjekteve në procesin e rivlerësimit”.

Për më tepër, janë në proces disa akte të tjerë, të cilët priten të miratohen së shpejti si:

- Metodologjia “Për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”.
- Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë”.
- Rregullorja e brendshme e KLP.

¹³ <https://klp.al/wp-content/uploads/2019/09/vendim-nr-169-25.09.2019-1.pdf>

- *Ndryshimet e fundme në përbërjen e anëtarëve të Këshillit*

Në muajin gusht 2019, KLP, me vendimin nr. 161, datë 02.08.2019, deklaroi mbarimin e mandatit të anëtarit të KLP-së, Z. Gentian Osmani, për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës, si rezultat i vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me nr. 20, datë 31.07.2019, i cili ka vendosur shkarkimin përfundimisht të Z. Gentian Osmani si prokuror. Në vijim, më datë 02.09.2019, Prokuroria e Përgjithshme hapi garën për vendin e lënë vakant nga Z. Gentian Osmani, duke ftuar prokurorët e shkallës së parë të paraqesin kërkesën për shprehjen e interesit për plotësimin e vendit vakant si anëtar në KLP.

Nga kandidatët që shprehën interesin për të kandiduar si anëtar në KLP, Prokuroria e Përgjithshme vendosi :

- ✓ **Z. Vladimir Mara**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, plotëson kushtet ligjore për të kandiduar si anëtar i KLP.
- ✓ **Znj. Esmeralda Keshi (Cami)**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, plotëson kushtet ligjore për të kandiduar si anëtar i KLP.

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e 1 (një) prokurori si anëtar i KLP, ku morën pjesë në votim 253 (dyqind e pesëdhjetë e tre) prokurorë, u shpall fituese Znj. Esmeralda Keshi (Cami) me 133 vota. Ndërsa Z. Vladimir Mara u rendit i dyti me 109 vota.

- *Procedura pas ngritjes së SPAK*

Duke pasur parasysh ritmin me të cilin po ecën Procesi i Vetingut në sistemin e drejtësisë, KLP, shumë shpejt, do të njoftojë krijimin SPAK. Menjëherë pas këtij çasti Këshilli do të emërojë Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme.

Pas emërimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme do të fillojë procesi për përzgjedhjen e Drejtorit të BKH. Ata që janë të interesuar për të aplikuar për pozicionin e Drejtorit të BKH-së duhet t'i referohen ligjit për SPAK. Neni 34, i këtij Ligji liston kriteret minimale që duhet të plotësohen nga kandidatët, ku përfshihet përvoja në punë, arsimimi dhe sjellja në të shkuarën.

BKH do të ketë në përbërje 60 hetues. Aplikantët për pozicionin e drejtorit dhe hetuesit të BKH-së duhet të dinë që procesi i përzgjedhjes do të jetë shumë rigoroz dhe sfidues. Ai është përcaktuar në Ligjin për SPAK dhe do të vlerësojë aftësitë profesionale, integritetin, si dhe aftësitë mendore e fizike të aplikantëve. Një njoftim paraprak është bërë në faqen zyrtare të KLP për të gjithë të interesuarit.

- ✚ *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), në zbatim të nenit 149/d të Kushtetutës, kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve për

Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, midis radhëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ata ushtrojnë mandatin e tyre për një vit. Më datë **7 dhjetor 2018**, Kryetari i Kuvendit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d të Kushtetutës, nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Urdhrit nr. 2, datë 3.12.2018, të Kryetarit të Kuvendit “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, zhvilloi procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm).

Në përfundim të hedhjes së shortit, u emëruan 8 anëtarë të Këshillit të Emërimit të Drejtësisë, si dhe tre anëtarë zëvendësues. Një nga anëtarët e KED, konkretisht Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, u shkarkua nga detyra me një vendim përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndërkohë dhe 1 anëtar zëvendësues është shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Rrjedhimisht, KED për vitin 2019 ka vetëm 7 anëtarë dhe dy anëtarë zëvendësues. **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**, i emëruar sipas këtij shorti, ushtron funksionin e tij për një vit kalendarik duke filluar nga **data 1 janar 2019**.

Për periudhën janar – korrik 2019, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm 2019), janë zhvilluar në total 25 mbledhje. Deri në muajin korrik 2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuara dhe publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë aktet si më poshtë vijon:

- a) Vendimi nr. 1, datë 08.02.2019 “*Rregullore e Brendshme “Për Funksionimin e KED”*”;
- b) Vendimi Nr. 2, datë 15.02.2019 “*Për Procedurën e Shortit të Caktimit të Relatorëve për Pozicionet Vakante në çdo Institucion*”;
- c) Vendimi Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për Procedurën e Verifikimit të Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”;
- d) Vendimi Nr. 5, datë 02.04.2019 “*Për Kriteret dhe Procedurën e Vlerësimit, Pikëzimit dhe Renditjes së Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”;
- e) Vendimi nr. 51, datë 21.06.2019 “*Metodologjia për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese*”;
- f) Vendimi nr. 52, datë 21.06.2019 “*Metodologjia për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë*”.

Për më tepër, gjatë periudhës gusht – shtator 2019, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm 2019), ka zhvilluar 8 mbledhje, ku është vijuar me:

- vlerësimin e kandidatëve;
- intervistimin e kandidatëve (platforma, vizioni, niveli i gjuhës së huaj etj);
- është rishqyrtuar një kandidat, i cili u kthye për rishqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit dhe në vijim u vendos përsëri ndalimi i kandidimit duke e lënë përfundimisht 6 kandidat në garë;
- është bërë vlerësimi përfundimtar i kandidatëve dhe është miratuar projekt-raporti përkatës;
- është rishpallur përsëri pozicioni vakant për Inspektor të Lartë të Drejtësisë;
- është hedhur shorti për përcaktimin e relatorit dhe këshilltarëve për pozicionin vakant të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Përsa i përket procedurave të verifikimit, në datë 01.03.2019, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm 2019) është vendosur “Shpallja për hapjen e Procedurës së Aplikimit në Pozicionin Vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”. Nga kjo shpallje kanë shprehur interes 12 kandidatë.

Në datë 05.04.2019, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm 2019) është hedhur shorti për caktimin e relatorëve për të gjithë kandidatët të cilët kishin aplikuar për pozicionet vakante për Gjykatë Kushtetuese, në total mbi 40 kandidatë.

Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm 2019), në përfundim të verifikimeve, duke përjashtuar kandidatët që kanë paraqitur dorëheqje, ka lejuar për të vijuar me procedurën e vlerësimit dhe pikëzimit vetëm **6 kandidatë për në Gjykatën Kushtetuese dhe 4 kandidatë për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.**

Nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është proceduar me vlerësimin e 6 kandidatëve të mbetur, për Gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, si dhe është bërë vlerësimi dhe pikëzimi përkatës për secilin, për 4 pozicione vakante, përkatësisht:

- Vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018;
- Vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 04.03.2019;
- Vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 12.02.2018;
- Vakancë e plotë, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 04.03.2019.

Për pozicionet e mësipërme, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është në fazën e fundit të përfundimit të raporteve përkatëse dhe shumë shpjetë lista me emërat dhe sipas pikëzimit të gjithësecilit do t'u dërgohen organeve të emërtesës sipas vendeve vakante.

Në vijim, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ka njoftuar organet e emërtesës, përkatësisht Kuvendin e Republikës dhe Presidentin e Republikës, për dy pozicionet e tyre vakante që kanë mbetur me pak se tre kandidatët.

Të dy organet e emërtesës kanë bërë shpalljet për aplikimit të personave të interesuar për vendet vakante për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese dhe rezultojnë se:

1- Kuvendi i Republikës ka përfunduar shpalljen dhe ka paraqitur pranë KED, listën me 6 kandidatë, të cilët kanë aplikuar për këtë vend vakant.

- KED ka vijuar procesin me hedhjen e shortit të relatorit dhe të këshilltarëve për këtë vend vakant.
- Ka vijuar procedurën e verifikimit të kandidatëve dhe është në fazën ku janë njoftuar kandidatët për marrjen në dorëzim të dokumentacionit përkatës dhe i kanë dorëzuar ato të plotësuar pranë KED.
- Kandidatët janë akoma në afat për dorëzimin e formularit të deklarimit të pasurisë pranë ILDKPKI, e cila është një procedurë që kryet pranë këtij institucioni.

- KED është në fazën e përgatitjes së shkresave për marrje informacioni nga të gjithë institucionet publike dhe private me qëllim verifikimin e kandidatëve sipas ligjit.

2- Presidenti i Republikës, për pozicionin vakant, është në fazën e shpalljes së thirrjes për aplikim të personave të interesuar.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 09.09.2019, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kandidatëve në garë, shpalli thirrjen për paraqitjen e kandidatëve për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në mbarim të afatit të shpalljes, rezultoi se janë paraqitur edhe 4 kandidatë të rinj që shprehin interesin për këtë vend vakant.

- Ka vijuar procedurën e verifikimit të kandidatëve dhe është në fazën ku janë njoftuar kandidatët për marrjen në dorëzim të dokumentacionit përkatës dhe i kanë dorëzuar ato të plotësuar pranë KED.
- Gjithashtu vlen të theksohet se kandidatët janë akoma në afat për dorëzimin e formularit të deklaramit të pasurisë pranë ILDKPKI, e cila është një procedurë që kryet pranë këtij institucioni.
- KED është në fazën e përgatitjes së shkresave për marrje informacioni nga të gjithë institucionet publike dhe private me qëllim verifikimin e kandidatëve sipas ligjit.

○ Procesi i vlerësimit dhe ecuria e institucioneve ri-vlerësuese

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është organ i ri kushtetues, me mandat 5-vjeçar, i krijuar me ndryshimet e reja të Kushtetutës, si pjesë e paketës për Reformën në Drejtësi, për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 82/2017, datë 17.6.2017, miratoi në bllok listën me 12 komisionerë. Veprimtaria e Komisionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i ligjit është rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve (subjekteve të rivlerësimit) në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni vlerëson çështjet e subjekteve të rivlerësimit në 4 trupa gjyqësore me 3 anëtarë secila, bazuar në tre kritere:

- a) Vlerësimi i pasurisë;
- b) Vlerësimi i figurës;
- c) Vlerësimi i aftësive profesionale.

Në total, deri më datë 30 shtator 2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **194 vendime**, nga të cilat:

- ✓ 83 vendime për konfirmimin në detyrë të 34 gjyqtarëve, 40 prokurorëve dhe 9 ndihmësve ligjorë;
- ✓ 71 vendime për shkarkimin nga detyra të 42 gjyqtarëve dhe 27 prokurorëve dhe 2 ndihmësve ligjorë /kandidatë për magjistratë;

- ✓ 15 vendime për ndërprerjen e procesit për 10 gjyqtarë, 4 prokurorë dhe 1 këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese; (neni G i Aneksit të Kushtetutës);
- ✓ 8 vendime për pushimin e procesit për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë (neni 56 i ligjit nr. 84/2016);
- ✓ 16 vendime për përfundimin e procesit për 10 gjyqtarë, 5 prokurorë dhe 1 (Kryeinspektorin) e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. (neni 95 i Kodi i Procedurave Administrative dhe neni 64 i ligjit nr. 96/2016);
- ✓ 1 vendim për pezullimin nga detyra të një prokurori.

Kolegji i Posaçëm i Apelit vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelit është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Deri më **30 shtator 2019**, në **Kolegjin e Posaçëm të Apelit** janë regjistruar 86 çështje (40 në vitin 2018 dhe 46 deri në shtator 2019) dhe janë shpallur 35 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit (12 në vitin 2018 dhe 23 vendime deri në shtator 2019). Nga 35 çështjet të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur:

- i. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - **në 23 vendime (8 janë të vitit 2018)**;
- ii. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me përmbajtjen në dispozitiv për, ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare - **në 3 vendime (2 janë të vitit 2018)**;
- iii. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - **në 7 vendime (1 vendim është i vitit 2018)**
- iv. Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra - **në 1 vendim**
- v. Pushimin e shqyrtimit të çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit nga ankuesi - **në 1 vendim (i përket vitit 2018)**.

Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve është parashikuar në nenin 53 të ligjit nr.84/2016; në këtë kuadër, gjatë periudhës janar 2019 – 30.09.2019 në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar dhe trajtuar **254** denoncime, ndërsa gjatë vitit 2018 janë regjistruar dhe trajtuar 136 denoncime.

Institucioni i **Komisionerëve Publikë** si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca:

- a. Ankimon në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 15 ditë pas njoftimit (neni 63 i ligjit nr. 84/2016).
- b. Përgatit raportin me shkrim me arsyet e refuzimit për moszbatimin e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (aneksi kushtetues, neni B “Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit).
- c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

Institucioni i Komisionerëve Publikë, për periudhën janar - shtator 2019, është njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për **103 vendime**. 8 prej tyre janë ankimuar dhe për 93 vendime është vendosur mosankim¹⁴. Në proces shqyrtimi ishin 6 vendime të KPK-së.

Në regjistrin e denoncimeve të publikut, për periudhën janar - shtator 2019, janë regjistruar **277 denoncime**.

Aktet nënligjore dhe normative të miratuara nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë.

- Rregullorja “Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë”;
- Rregullore e brendshme administrative e Institucionit të Komisionerëve Publikë;
- Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerëve Publikë;
- Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Institucionin e Komisionerëve Publikë”;
- Rregullore për median.

Ministria e Drejtësisë ka lehtësuar procesin e rivlerësimit në tre drejtime kryesore:

- Duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për organet e rivlerësimit;
- Duke siguruar mjetet financiare për organet e rivlerësimit;
- Duke bashkëpunuar me organet e vetingut mbi kërkesat për informacion të paraqitura në kuadër të procesit të rivlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit që po kryhen nga këto organe.

II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, në Ministrinë së Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën nga *1 janar 2019 deri në 30 shtator 2019* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit të SND-së. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivit dhe aktivitetit, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të masave, procesi i

¹⁴ Në rubrikën mosankim janë përfshirë 4 vendimet e KPK-së, të njoftuara në fund dhjetori 2018, për të cilat vendimarrja është realizuar në Janar 2019.

monitorimit është kryer në nivel objektiv. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht online, për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura.


Pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft-raportin e monitorimit para se të miratohet nga Mekanizmi Institucional i Monitorimit/Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi.

III. DISBURSIMI FINANCIAR

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitet 2017 - 2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë ishte vlerësuar në 98,385,653 Euro. Në kuadër të thellimit të angazhimit të zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe reflektimin e saj në zbatimin e Planit të Veprimit, Ministria e Drejtësisë ka rishikuar Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për periudhën 2019 - 2021. Në vijim, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 409, datë 19.06.2019 miratoi Planin e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Përsa i përket kostove të parashikuara në Planin e Veprimit për vitet 2019 – 2021, rezulton se:

- 3.165.677 (në mijë lekë) mbulohen nga buxheti i shtetit;
- 5.830.122 (në mijë lekë) mbulohen nga donatorët¹⁵.



¹⁵ Buxhetimi i masave të profesioneve të lira ligjore do të mbulohet nga të ardhurat e vetë Dhomave, si ente private me vetëfinansim.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2019 - 2021, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi shpenzimet në bazë të aktivitetit të kryer. Nga analiza për masat e raportuara rezulton se për periudhën janar – shtator 2019 janë shpenzuar në total nga buxheti i shtetit rreth 209,846 (mijë) lekë dhe nga donatorët 2,532 (mijë) lekë.


IV. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së secilit objektiv të Strategjisë dhe pasqyron grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për periudhën janar – shtator 2019¹⁶.

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.


Numri i masave në zbatim sipas objektivit 1

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 1	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 1
Të realizuara	3	23%
Në proces	8	62%
Të porealizuara	2	15%
Totali	13	100%



¹⁶ Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është pasqyruar në aneksin 2 të Raportit të Monitorimit.

Përqindja e statusit të masave




Rezulton se nga 13 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 1 janë realizuar 3 prej tyre, 8 janë ende në proces zbatimi dhe 2 masa të porealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektivi është në nivelin 23% për masat të cilat janë të realizuara, 62% masat në proces, si dhe 15% masat të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.


Numri i masave në zbatim sipas objektivit 2

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 2	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 2
Të realizuara	1	25%
Në proces	2	50%
Të porealizuara	0	0%
Të paraportuara	1	25%
Totali	4	100%

Statusi i masave të Objektivit 2



Përqindja e statusit të masave




Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 2 është realizuar 1 prej tyre, 2 janë ende në proces zbatimi, si dhe 1 masë është e paraportuar nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 25% për masën e realizuar, 50% masat në proces, si dhe 25% masa e paraportuar nga institucioni përgjegjës.

Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 3

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 3	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 3
Të realizuara	0	0%
Në proces	4	80%
Të porealizuara	1	20%
Totali	5	100%




Rezulton se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 3 janë ende në proces zbatimi 4 prej tyre dhe 1 masë të porealizuara nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektiv është në nivelin 80% për masat në proces dhe 20% masa e cila do të zbatohet në vijim nga institucioni përgjegjës.

Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 4

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 4	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 4
Të realizuara	1	25%
Në proces	2	50%
Të porealizuara	1	25%
Totali	4	100%




Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 4 është realizuar 1 prej tyre, 2 janë ende në proces zbatimi dhe 1 masë e porealizuar nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 25% për masën e cila është e realizuar, 50% e masave në proces dhe 25% masa e cila do të zbatohet në vijim nga institucioni përgjegjës.

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 5

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 5	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 5
Të realizuara	2	18%
Në proces	8	73%
Të porealizuara	1	9%
Totali	11	100%




Rezulton se nga 11 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 5 janë realizuar 2 prej tyre, 8 janë ende në proces zbatimi dhe 1 masë të porealizuar nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 18% për masat të cilat janë të realizuara, 73% masat në proces dhe 9% masa e cila do të zbatohet në vijim nga institucioni përgjegjës.

Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 6

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 6	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 6
Të realizuara	3	60%
Në proces	2	40%
Të parealizuara	0	0%
Totali	5	100%



Rezultoni se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 6 janë realizuar 3 prej tyre dhe 2 janë ende në proces zbatimi. Për qindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektivi është në nivelin 60% për masat të cilat janë të realizuara dhe 40% masat në proces.

Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 7

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 7	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 7
Të realizuara	2	18%
Në proces	9	82%
Të parrealizuara	0	0%
Totali	11	100%




Rezultoni se nga 11 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 7 janë realizuar 2 prej tyre dhe 9 janë ende në proces zbatimi. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 – 2021 për këtë objektiv është në nivelin 18% për masat të cilat janë të realizuara dhe 82% për masat në proces.

Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.

Numri i masave në zbatim sipas objektivit 8

Janar – Shtator 2019		
Statusi i zbatimit të masave të Objektivit 8	Numri i masave	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 8
Të realizuara	1	8%
Në proces	4	34%
Të porealizuara	0	0%
Të paraportuara	7	58%
Totali	12	100%



Rezultoni se nga 12 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 8 është realizuar 1 prej tyre, 4 janë ende në proces zbatimi, si dhe 7 masa janë të paraportuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2019 - 2021 për këtë objektivi është në nivelin 8% për masat të cilat janë të realizuara, 34% masat në proces, si dhe 58% masat e paraportuara nga institucionet përgjegjëse.

V. ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – SHTATOR 2019.

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën nëntëmujore, në zbatim të Planit të Veprimit 2019 – 2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë si më poshtë vijon:

- Një hap vendimtar në zbatimin e reformës në drejtësi shënoi ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë muajit dhjetor 2018, të cilat janë dy shtyllat për një sistem gjyqësor të pavarur dhe cilësor. Për më tepër, gjatë periudhës së raportimit, KLGJ dhe KLP kanë marrë një sërë iniciativash dhe në këtë kuadër janë miratuar rregullore të ndryshme sipas fushës së përgjegjësisë së secilit institucion.
- KLGJ vazhdon të jetë e angazhuar intensivisht në mbështetjen e procesit të rivlerësimit, ndër të tjera edhe me hartimin e raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.
 - Deri më datë 30 shtator 2019, janë përgatitur dhe dorëzuar pranë KPK dhe ONM 196 raporte vlerësimi. Objektivi për vitin 2019 për dorëzimin e ¼ të raporteve është plotësisht i realizueshëm.
- KLP është organi i ngarkuar për vlerësimin e punës të prokurorëve duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar. Me Vendimin nr. 6, datë 26.12.2018 është krijuar “Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale”.
 - Me Vendimin nr. 32, datë 22.02.2019, KLP vendosi të komandojë 6 magjistratë, prokurorë, për hartimin e draft-raporteve të vlerësimit profesional në kuadër të rivlerësimit.
 - KLP, në bashkëpunim me KPK, kanë organizuar shortet për përzgjedhjen në mënyrë rastësore, të pesë akteve dhe dosjeve, për 39 prokurorë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë, Berat, Mat, Lushnjë Vlorë, Kurbin, Pogradec dhe Durrës.
 - Janë përgatitur dhe janë miratuar në seancë plenare nga KLP dhe janë përcjellë në KPK 35 raporte për subjekte prokurorë.
 - Gjithashtu, janë përgatitur dhe janë miratuar raportet për 18 prokurorë kandidatë, që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, si edhe është përfunduar dhe dorëzuar vlerësimi profesional i një kandidati për prokuror të përgjithshëm.
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka filluar punën zyrtarisht në datë 15.01.2019 dhe për një periudhë nëntëmujore ka realizuar një punë voluminoze, delikate dhe produktive, duke miratuar të gjithë aktet dhe rregulloret e nevojshme për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si dhe Rregulloren e Brendshme “Për Funkcionimin e KED”.
 - KED ka përmblylluar procedurat e verifikimit dhe vlerësimit për 4 pozicione vakante të Gjykatës Kushtetuese (2 të Kuvendit dhe 2 të Presidentit), si dhe janë dërguar listat me emërat e kandidatëve respektiv organeve të emërtesës.

- KED aktualisht ka nisur përsëri verifikimet e kandidatëve për 2 pozicione të tjera vakante (1 i Kuvendit ku kanë aplikuar 6 kandidatë dhe 1 i Presidentit ku kanë aplikuar 6 kandidatë), për plotësimin e kushteve ligjore dhe kriterëve të tjera ligjore, si dhe ka vijuar edhe me verifikimin e 4 kandidatëve të rinj që kanë aplikuar për ILD, pas shpalljes së bërë nga KED në datë 09.09.2019.
- Referuar ligjit 96/2016, kanë ndryshuar pagat e magjistratëve për vitin 2019. Zbatimi i sistemit të ri të pagave dhe përfitimeve të tjera për magjistratët kanë hyrë në fuqi në datën 1 janar 2019, sipas parashikimeve të ligjit *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.
- Këshilli pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, në bashkëpunim me Misionin EURALIUS V, është angazhuar në përmirësimin e programit të provimit të pranimit të kandidatëve për magjistratë dhe kandidatëve për këshilltarë e ndihmës ligjorë. Ndryshimet konsistuan në anën strukturore të pyetjeve të testimit dhe përditësimin e programit të provimit të pranimit me ligjet e ndryshuara.
 - Në bashkëpunim me Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID është krijuar kurrikula për formimin profesional fillestar të kancelarëve, të trajnuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit. Kurrikula përshin 14 module të cilat ofrojnë udhëzime gjithëpërfshirëse në fushat e përgjegjësisë funksionale që lidhen me administrimin e gjykatave, si dhe aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale të nevojshme për të udhëhequr reformën në gjyqësor. Mbulimi financiar i të gjithë projektit është bërë nga EWMI, Justice For All.
 - Shkolla e Magjistraturës ka botuar 3 numra të Revistës “Jeta juridike”, konkretisht nr. 3 të vitit 2018, nr. 1 të vitit 2019 dhe nr.2 të vitit 2019, me nga 300 kopje për secilin numër. Nën kujdesin e Shkollës së Magjistraturës janë botuar dy tituj shkencorë, njëri në fushën e të drejtës procedurale penale dhe tjetri në të drejtën civile.
 - Komentari elektronik është një platformë e krijuar dhe zhvilluar nga Misioni EURALIUS ku tashmë janë komentuar 247 dispozita të ligjeve të reformës në drejtësi nga Misioni. Aktualisht, platforma mbahet fizikisht në serverin e SHM dhe është e aksesueshme pa pagesë. Komentari elektronik synon të shoqërojë zbatimin e plotë të reformës në drejtësi, duke futur në vend në të njëjtën kohë një kulturë të re akademike të ngjashme me atë të vendeve evropiane që ka të bëjë me një analizë të thellë dhe të plotë të dispozitave ligjore.
 - Për më tepër, deri më tani është investuar në pasurimin e bibliotekës së Shkollës së Magjistraturës. Konkretisht, fondi i Bibliotekës së Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Janar-Shtator 2019, është rritur me 85 njësi bibliotekare, nga të cilat 50 njësi janë monografi në fushën e jurisprudencës, 15 tema të kandidatëve për magjistratë të vitit të dytë dhe 10 seriale.
- Është ndërtuar sistemi i integruar për publikimin e ligjeve të konsoliduara dhe akteve nënligjore të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave (Arkiva Elektronike e QBZ), e cila ka përfunduar në datë 29.03.2019. Projekti ka arritur objektivin e përgjithshëm: krijimin e Sistemit të Arkivës Elektronike të Akteve, që shërben për rregjistrimin, editimin,

publikimin, përditësimin, ruajtjen, administrimin dhe aksesimin e të gjithë akteve të botueshme në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, politikat kombëtare dhe praktikave më të mira në botë në këtë drejtim.

- Në zbatim të ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” janë hartuar dhe miratuar aktet e Këshillit të Ministrave:
 - Vendimi nr.110 datë 06.03.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
 - Vendimi nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;
 - Udhëzimi nr. 1, datë 6.3.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.
- Ministri i Drejtësisë ka miratuar aktet nënligjore në zbatim të ligjit 111/2017:
 - Udhëzimi nr.1 datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”;
 - Udhëzimi nr.2 datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”;
 - Urdhri nr.225 datë 25.3.2019 "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti";
 - Urdhri nr.226 datë 25.3.2019 "Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti".
 - Udhëzimi nr.6 datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave dhe e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”.
- Përsa i përket krijimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, gjatë muajit mars 2019, me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 59, dt.25.03.2019 është miratuar struktura dhe organika e kësaj drejtorie, e cila është në proces plotësimi të vendeve vakante nga DAP.
 - Për periudhën Janar – Shtator 2019 është dhënë ndihmë juridike dytësore në vlerën 7 741 000 lekë.
- Në kuadrin e ushtrimit të kompetencave Kushtetuese e ligjore në funksion të rritjes së efencës, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerr aktet normative si më poshtë:
 - Udhëzimi i Përgjithshëm nr.3 datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”;

- Udhëzimi i Përgjithshëm nr.2 datë 24.05.2019 “Për zbatimin e ligjit lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë”;
 - Urdhri nr.101 datë 12.06.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për emërimin e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;
 - Është miratuar udhëzimi i përgjithshëm “Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, punuar në bashkëpunim me ekspertët e EURALIUS-it.
- Përsa i përket investimeve në infrastrukturë, Prokuroria e Përgjithshme ka realizuar rikonstrukcionin e pjesshëm në Prokurorinë e Apelit Vlorë dhe në Prokurorinë Përmet.
- Çështja e mbipopullimit në nivel të përgjithshëm në sistemin e burgjeve është një problematikë e zgjidhur. Kapacitet totale të sistemit të burgjeve janë 6106 vende dhe gjatë janar-shtator 2019 janë trajtuar mesatarisht 5400 persona, prej të cilëve 258 shtetas me masë mjekësore mjekim i detyruar.
- Niveli i popullimit për periudhën janar-shtator 2019 ka qenë mesatarisht -11% (-680). Pra, sistemi i burgjeve në nivel të përgjithshëm ka qenë në kushtet e nënpopullimit.
 - Eliminimi i mbipopullimit në burgje ka ardhur si rezultat i masave konkrete qoftë në investime, si hapja e burgut të ri në Shkodër, investim i Bashkimit Evropian dhe Qeverisë Shqiptare, si dhe ndërtimi i dy godinave të reja në I EVP Jordan Misja, Tiranë, investim i Qeverisë Shqiptare, ashtu edhe përmes kryerjes rast pas rasti të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe akomodimit të burgosurve në I EVP.
 - Organikat e punës për të paraburgosurit dhe të dënuarit për periudhën janar-shtator 2019 kanë pasur një numër prej mesatarisht 649 personash të punësuar: të paraburgosur 144 dhe të dënuar 505. Të burgosurit aktivizohen në aktivitete punësimi sipas mundësive që ofrojnë institucionet, kryesisht si mirëmbajtës, ndihmës kuzhinier, kopshtar etj.
 - Gjatë periudhës janar-shtator 2019 në I EVP janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 153 tema sociale në muaj dhe 29 recensione librash. Gjithashtu, janë zhvilluar 489 aktivitete ri-integruese.
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve, Kryeministria ka zhvilluar një trajnim 5-ditor në kuadër të zhvillimit të sitemit IPSIS, me qëllim njohjen dhe përdorimin e moduleve respektive, kryesisht në kuadër të hartimit të politikave të kuadrit strategjik, strategjive sektoriale dhe prioriteteve të qeverisë, PKIE-së, planit analitik të projekt-akteve, si dhe zhvillimin e programeve dhe projekteve strategjike.
- Fokus i veçantë në modulet respektive u dha lidhur me pasaportat e indikatoreve, si dhe kostimin e dokumentave politike.

VI. KONKLUSIONE

Realizimi i reformës në drejtësi është një proces i vazhdueshëm ndërsektorial, ku vetë përcaktimi dhe matja e treguesve përfundimtar të suksesit është kompleks, sidomos në një kuadër ligjor dhe institucional në reformim të vazhdueshëm.

Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikatat më të mira evropiane mbetet misioni i kësaj strategjie.

Gjatë kryerjes së procesit të monitorimit janë evidentuar disa problematika që vlerësohen se kanë ndikuar në nivelin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Ndër elementët më të rëndësishëm të cilët kanë ndikuar në realizimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit janë si më poshtë:

- ❖ Moskrijimi në kohë i institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë si: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, SPAK dhe Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
- ❖ Me hyrjen në fuqi të Planit të ri të Veprimit 2019 – 2021 (të miratuar me VKM Nr. 409, dt. 19.06.2019), institucionet përgjegjëse kanë pasur një kohë relativisht të shkurtër për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në PV.

Gjatë kësaj periudhe, zbatimi dhe monitorimi, si dy procese të ndërlidhura që kanë orientuar Ministrinë e Drejtësisë drejt reflektimit dhe konkluzioneve, mund të përmendim ndër më kryesoret:

- ✚ Mbetet problematike përgjegjshmëria e institucioneve për të raportuar në kohë dhe me cilësi lidhur me informacionin mbi masat e Planit të Veprimit. Nevojitet një bashkëpunim më i lartë i Dhomave, për të kontribuar dhe raportuar lidhur me implementimin e Planit të Veprimit 2019 - 2021, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.
- ✚ Mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit, ndikon në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë.
 - Institucionet kanë raportuar se hasin vështirësi në raportim lidhur me:
 - buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga donatorët (informacion i cili nuk disponohet nga pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese);
 - buxhetin e shpenzuar për realizimin e aktiviteteve të mbuluara nga buxheti i shtetit (mungesa e një metodologjie në lidhje me kostimin e aktiviteteve sjell pengesa në raportimin e kostove faktike mbi realizimin e tyre);

VII. SFIDAT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2019 - 2021, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- ✚ Sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi gjatë fazave të raportimit, monitorimit me institucionet përgjegjëse dhe grupet e interesit.
- ✚ Sfidë mbetet dhe dokumenti i Pasaportës së Treguesve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, pasi institucionet do të raportojnë për herë të parë mbi 11 treguesit e SND-së, gjatë hartimit të Raportit Vjetor të Monitorimit.
- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitutional.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- ✚ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.

ANEKS 1

Ligjet e miratuara nga paketa e ligjeve të reformës në drejtësi janë si më poshtë vijon:

1. Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 36/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;
3. Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”;
4. Ligji nr. 32/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 69/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 04.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, i ndryshuar”;
6. Ligji nr. 70/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;
7. Ligji nr. 43/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013 “Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit”;
8. Ligji nr. 44/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
9. Ligji nr. 42/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
10. Ligji nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
11. Ligji nr. 40/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
12. Ligji nr. 39/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar”;
13. Ligji nr. 41/2017 “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”;
14. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
15. Ligji nr. 98/2017 “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”;
16. Ligji nr. 26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
17. Ligji nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;
18. Ligji nr. 80/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar;

19. Ligji nr. 86/2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”;*
20. Ligji nr. 110/2018 *“Për Noterinë”;*
21. Ligji nr. 25/2019 *“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”;*
22. Ligji nr. 26/2019 *“Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”;*
23. Vendimi i Kuvendit nr. 47/2019, datë 18.04.2019 *“Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 – 2023”.*

DRAFT

Plani i Veprimit 2019 - 2021

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë

(Për periudhën janar - shtator 2019)

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë

Nën-objektivi 1/a: Pavarësia e institucioneve të sistemit të drejtësisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane

Indikatori / Treguesi:

% e gjyqtarëve që besojnë se gjyqtarët janë emëruar/caktuar/promovuar jo në bazë të aftësive dhe eksperiencës në dy vitet e fundit.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Target 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Hartimi i bazës nënligjore për përcaktimin e kriterëve dhe standardeve të meritokracisë dhe transparencës në emërimet dhe promovimet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe administratës gjyqësore.	KLJGJ, KLP	Kryerja e studimit të nevojshëm dhe përgatitja e draftit. Diskutimi dhe miratimi nga KLJGJ e KLP. Zbatimi i standardeve		7 400			Në proces	KLJGJ: KLJGJ ka vijuar intensivisht punën për plotësimin e bazës nënligjore, sipas përcaktimeve të ligjeve 96/2016 dhe 98/2016 por edhe të Planit Strategjik të KLJGJ-së 2019-2020. Mund të përmendet: - Vendimi i KLJGJ Nr.75 datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. - Vendim i KLJGJ Nr.102 datë 5.07.2019 “mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

								<p>KLP: Për periudhën janar – shtator 2019, KLP ka miratuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”; - Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”; - Metodologjinë e punës së Komisionit të Posaçëm “Për Vlerësimin e Kandidatëve për Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”; - Rregullore “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”; - Rregullore “Për vlerësimin etik dhe profesional të subjekteve në procesin e rivlerësimit”; - Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”; - Rregullore “Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit zyrtar”. - Së fundi, KLP ka miratuar në seancën plenare, me Vendimin nr. 171, datë 27.09.2019, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”. <p>Pritet të miratohet së shpejti:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodologjia “Për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”;
--	--	--	--	--	--	--	--	---

							<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në shkallët më të larta dhe në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë”, • Rregullorja e brendshme e KLP. 	
2. Hartimi dhe vënia në funksionim e një platforme/ metodologjie/praktike (pyetësor, sondazhi online etj) për monitorimin periodik të perceptimit të magjistratëve mbi pavarësinë e brendshme të gjyqësorit.	KLGG, KLP	Hartimi i metodologjisë dhe vënia në funksionim të sistemit të monitorimit. Kryerja e sondazhit nr. 1		700			E parealizuar	Për periudhën janar-shtator 2019 nuk ka zhvillime.
3. Rritja e transparencës së vendimmarrjes në procesin e emërimeve / promovimeve të gjyqtarëve.	KLGG	Publikimi i kriterëve, kandidatëve, metodologjisë së vlerësimit dhe vendimmarrjes	10 000				E realizuar	Të gjitha vendimet e KLGG, sipas ligjit 115/2016, publikohen në faqen zyrtare të KLGG dhe sipas rastit në fletoren zyrtare. Kriteret dhe metodologjia e vlerësimit janë pjesë e vendimeve normative dhe po kështu, metodologjia e vlerësimit. Lista e kandidatëve shpallet në rubrikën njoftime ndërsa për sa i përket vendimmarrjes, në respekt të të dhënave personale, gjendet në procesverbalet e mbledhjeve. Specifikisht referuar kësaj pike, mund të përmenden vendimet e cituara në pikën 1, të këtij objekti. Deri më datë 10 Tetor 2019 janë miratuar dhe publikuar 203 vendime që janë të aksesueshme në faqen zyrtare të KLGG www.klgj.al/vendime .
4. Mbështetja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet hartimit të raporteve të hollësishme dhe të	KLD/KLGG/ KLP	1/4 e subjekteve (Mbledhja e statistikave, kryerja e shortit, mbledhja e	232 000				E realizuar	Nga 466 subjekte të rregjistruara fillimisht për t’ju nënshtruar procesit të vetingut, deri më datë 10 tetor 2019, KLGG dhe KLD kanë përfunduar dhe dorëzuar raportet për 199 subjekte të rivlerësimit. Për periudhën janar - shtator 2019 janë organizuar 97 shorte për

<p>arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.</p>		<p>informacionit të nevojshëm, analiza e informacionit, hartimi i relacionit dhe inventarizimi i praktikës.)</p>					<p>përzgjedhjen e 5 dosjeve për 97 subjekte të rivlerësimit kalimtar dhe KLGJ ka përfunduar dhe dorëzuar 88 raporte të hollësishme dhe të arsyetuara për analizën e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.</p> <p>Objektivi për vitin 2019 për dorëzimin e ¼ të raporteve është plotësisht i realizueshëm.</p> <p>KLP: KLP është organi i ngarkuar për vlerësimin e punës të prokurorëve duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar.</p> <p>Me Vendimin nr. 6, datë 26.12.2018 është krijuar “Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale”.</p> <p>Ky komision vlerëson punën, si dhe përgatit raportet e aftësive profesionale të prokurorëve, në kuadër të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Me Vendimin nr. 32, datë 22.02.2019, KLP vendosi të komandojë 6 magjistratë, prokurorë, për hartimin e draft-raporteve të vlerësimit profesional në kuadër të rivlerësimit.</p> <p>KLP, në bashkëpunim me KPK, kanë organizuar shortet për përzgjedhjen në mënyrë rastësore, të pesë akteve dhe dosjeve, për 39 prokurorë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë, Berat, Mat, Lushnjë Vlorë, Kurbin, Pogradec dhe Durrës.</p> <p>Mbështetur në kriteret e përcaktuara në bashkëpunim me KPK-në, janë përgatitur raportet për analizimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit</p>
---	--	--	--	--	--	--	---

							<p>kalimtar.</p> <p>Janë përgatitur dhe janë miratuar në seancë plenare nga KLP dhe janë përcjellë në KPK 35 raporte për subjekte prokurorë.</p> <p>Gjithashtu, janë përgatitur dhe janë miratuar raportet për 18 prokurorë kandidatë, që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, si edhe është përfunduar dhe dorëzuar vlerësimi profesional i një kandidati për prokuror të përgjithshëm.</p> <p>Nga ana e KLP-së, vijon puna për përgatitjen e raporteve të prokurorëve të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, dhe të Apelit, të shortuara nga KPK.</p>
<p>5. Ngritja dhe vënia në funksion e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me qëllim të rishikimit të CV-ve të anëtarëve të institucioneve të drejtësisë.</p>	KED	<p>Ngritja e KED;</p> <p>Hartimi i kriterëve, metodologjisë së vlerësimit dhe vënien në funksionim të sistemit.</p> <p>Publikimi i kriterëve të hollësishme, kandidatëve, metodologjisë së vlerësimit dhe vendimmarrjes.</p> <p>Vënia e KED në funksionim të plotë;</p>		13 000	7 778 (mijë lekë)	E realizuar	<p>Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar në datë 21.06.2019, përkatësisht me vendimet nr.51 dhe nr.52 “Metodologjin për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”, të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në seksionin e posaçëm të KED, rubrika Legjislacioni, kategoria “Aktet Normative të KED”.</p> <p>KED në bazë të organikës që ka, të caktuar nga ana e Gjykatës së Lartë, ka vijuar funksionimin normal të punës dhe është në funksionim të plotë.</p> <p>KED ka përmbylluar procedurat e verifikimit dhe vlerësimit për 4 pozicione vakante të Gjykatës Kushtetuese (2 të Kuvendit dhe 2 të Presidentit), si dhe janë dërguar listat me emërat e kandidatëve respektiv organeve të emërtesës.</p>

								<p>KED, aktualisht ka nisur përsëri verifikimet e kandidatëve për 2 pozicione të tjera vakante (1 i Kuvendit ku kanë aplikuar 6 kandidatë dhe 1 i Presidentit ku kanë aplikuar 6 kandidatë), për plotësimin e kushteve ligjore dhe kriterëve të tjera ligjore, si dhe ka vijuar edhe me verifikimin e 4 kandidatëve të rinj që kanë aplikuar për ILD, pas shpalljes së bërë nga KED në datë 09.09.2019.</p> <p>Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 298, datë 10.5.2019, është miratuar fondi prej <u>13 229 904</u> lekë, për “Shpenzime personeli” dhe “Shpenzime operative”, në mbështetje të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.</p> <p>Fondet e shpenzuara për periudhën janar-shtator 2019 janë në shumën <u>7. 777. 932</u> lekë.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

Nën-objektivi 1/b: Përmirësimi i efikasitetit të sistemit të drejtësisë

Indikatori / Treguesi:

1. % e uljes së kohëzgjatjes mesatare të një çështje penale (vlera të ndara për shkallën e parë dhe për apelin, vetëm juridiksioni i zakonshëm).
2. % e uljes së kohëzgjatjes mesatare të një çështje civile në shkallën e parë dhe në Apel (vlera të ndara për secilën shkallë gjyqësore).
3. % e çështjeve civile të vendosura në jo më shumë se tre seanca gjyqësore (vetëm në shkallë të parë).

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Target 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1.Funksionimi i plotë i KLGJ-së e KLP-së me kuadrin rregullator, kapacitetet dhe infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur	KLJG KLP	Planifikimi afatmesëm i përmirësimeve të nevojshme në infrastrukturë. Procedurat e brendshme dhe	30 000	1 470 000	71 894 (mijë lekë) KLJG			KLJG: Përmirësim i infrastrukturës së KLJG do të zbatohet në kuadër të implementimit të projektit të “Polit të drejtësisë” (VKM Nr. 234, datë 17.4.2019 “për programin e integruar të zhvillimit “Poli i Drejtësisë”.

<p>funksionin.</p>		<p>manualet e vlerësimit të gjyqtarëve e prokurorëve janë përfunduar.</p> <p>Organigrama e miratuar, stafi i KLGJ-së e KLP-së i plotësuar.</p> <p>Zbatimi në masën 40% i përmirësimeve të nevojshme në infrastrukturë.</p> <p>Analizë dhe plan veprimi për rritjen e normës së likujdimit dhe uljen e kohëzgjatjes mesatare të çështjeve penale dhe civile në gjykatat Tiranë dhe Durrës (rreth dhe apel)</p> <p>Të paktën 4 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë janë emëruar nga KLGJ.</p>					<p>Në proces</p>	<p>Komisioni për Vlerësimin Etik dhe Profesional është në proces për hartimin e një akti nënligjor për përcaktimin e standardeve të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve; dhe një akti nënligjor për përcaktimin e standardeve të vlerësimit të performancës së administratës gjyqësore, në pajtim me IFCE dhe CEPEJ.</p> <p>Organigrama e KLGJ është miratuar (Vendimi nr. 44 datë 12.03.2019, i ndryshuar me Vendim nr. 80, datë 30.05.2019) me një staf prej 125 punonjësish menjëherë pas daljes së aktit normativ të përcaktimit të buxhetit (qershor 2019) dhe është në proces rekrutimi i stafit.</p> <p>Analiza mbi normën e likujdimit të çështjeve është bërë në shkallë vendi në kuadrin e raportit vjetor të KLGJ-së. Përsa i përket veprimeve konkrete për rritjen e normës të likujdimit të çështjeve, KLGJ ka ndërmarrë një numër masash në lidhje me delegimet e gjyqtarëve dhe transferimin e përkohshëm (Këshilli ka shqyrtuar 608 kërkesa për caktim gjyqtari gjithsej, në përgjigje të të cilave ka caktuar 895 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, për të bërë një shërndarje më të mirë të resurseve.) Po në këtë drejtim shërben edhe Vendimi Nr.78 datë 30.05.2019 “për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.</p> <p>Rregullat për kriteret dhe procedurën për promovimin e magistratëve në Gjykatën e Lartë ka përfunduar (vendimi nr. 75, datë 23.05.2019); miratimi i rregullave për kriteret dhe procedurën për emërimin e jo</p>
--------------------	--	---	--	--	--	--	------------------	---

					20,267 (mijë lekë) (KLP)		<p>gjqytarëve në Gjykatën e Lartë ka përfunduar: Vendimi Nr.102 datë 5.07.2019; Shpallja e procedurës së emërimit në gjykatën e lartë, nga radhët e juristëve të spikatur është publikuar më datë 10.07.2019 (vendimi Nr.108 datë 9.07.2019.) dhe me vendimin nr. 179 datë 11/09/2019. Si përfundim, KLGj tashmë ka hapur thirrjen për kuotën e 1/5 ose 4 vendeve në Gjykatën e Lartë dhe pas përfundimit të shqyrtimit të raundit të parë të aplikimeve, po përfundon procedurat e nevojshme për verifikimin e integritetit, aftësiwe profesionale dhe pasurisë së kandidatëve të kualifikuar. Me vendimin nr. 209, datë 11.10.2019, KLGJ miratoi edhe metodologjinë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo-gjqytarë. Së shpejti pritet që të paktën 4 gjyqtarë të ardhur nga juristë të shquar (jo-gjqytarë) të emërohen dhe të formojnë një trupë gjyquese funksionale në Gjykatën e Lartë.</p> <p>KLP: Përmirësimi i infrastrukturës së KLP kushtëzohet nga finalizimi i implementimit të projektit të “Polit të drejtësisë”.</p> <p>Organigrama e miratuar nga Këshilli i Ministrave ka një numër prej 65 punonjësish.</p> <p>Buxheti vjetor i alokuar ka shumën prej 108 milionë lekësh, për periudhën 7-mujore, duke filluar efektet financiare më 1 Qershor 2019.</p> <p>Me vendimin nr. 149, datë 02.09.2019, është kryer procedura e rishikimit të projektbuxhetit afatmesëm 2020-2022.</p> <p>KLP është në proces rekrutimi të stafit. Me</p>
--	--	--	--	--	-----------------------------------	--	--

								vendimin nr. 150, datë 22.07.2019, janë miratuar detyrat e administratës së KLP dhe kanë filluar procedurat e rekrutimit sipas ligjit për nëpunësin civil.	
2. Riorganizimi i hartës gjyqësore dhe prokuroriale, si dhe të policisë gjyqësore dhe shpërndarjen e gjykatave në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe numrin e çështjeve të pazgjidhura gjyqësore me qëllim forcimin e rolit dhe funksionimit të gjykatave dhe për të siguruar qasje në drejtësi.	KLJGJ	Kryerja e studimit të nevojshëm dhe hartimi i draftit. Miratimi dhe zbatimi i hartës gjyqësore.		762 500				Në proces	Përcaktimi i juridiksionit territorial dhe përmasave të gjykatave është në proces. Grupi i ndërinstitucional i punës, (i përbërë nga përfaqësues nga gjykatat e vendit, KLGJ, Ministria e Drejtësisë dhe partnerë ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës, EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të Gjithë”- JUST/USAID), bazuar në metodologji dhe standarde ndërkombëtare, pas një analize paraprake, ka zhvilluar 6 takime. Aktualisht janë në përfundim tre draft – opsionet e para të hartës së re gjyqësore.
3. Ngritja e një plani pune për reduktimin e numrit të çështjeve të mbartura.	KLJGJ/GJL	Analiza dhe hartimi i Planit të Veprimit; Miratimi i Planit të Veprimit.	2 332					E porealizuar	Për periudhën janar-shtator 2019 nuk ka zhvillime.

Nën-objektivi 1/c: Përmirësimi i llogaridhëniens së institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas standardeve evropiane

Indikatori /Treguesi:

% e procedimeve disiplinore të nisura ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që rezultojnë me sanksione (përf. vendimet me marrëveshje).

Ulja e numrit të çështjeve të bartura në vlerësimin e performancës vjetore të gjyqtarëve.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		

<p>1. Krijimi i Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, të ngarkuar me përgjegjësinë për të verifikuar ankesat, hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjithë niveleve, anëtarëve të KLGJ e KLP, Prokurorit të Përgjithshëm dhe për të zhvilluar shërbime të tjera të inspektimit në gjykata dhe prokurori në pajtim me standardet evropiane.</p>	<p>Kuvendi i RSH ILD</p>	<p>Ngritja e ILD; Miratimi i procedurave të brendshme të funksionimit të tij; Miratimi i manualeve e inspektimit; Rekrutimi i stafit/inspektorëve.</p>	<p>74 211</p>				<p>Në proces</p>	<p>Kuvendi: Në bazë të nenit 201 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Kuvendi i Shqipërisë është e varur me përfundimin e procesit të verifikimit, përzgjedhjes dhe renditjes së kandidaturave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Aktualisht KED ka përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe kushteve ligjore për 8 kandidatët për Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Në përfundim të këtij procesi KED ka vendosur lejimin e kandidimit për 4 kandidatë dhe ndalimin e kandidimit për 4 kandidatë. Duke qenë se numri i kandidatëve të lejuar për kandidim për Inspektor të Lartë të Drejtësisë ishte më pak se 5 kandidatë, siç e parashikon kushtetuta dhe ligji, KED në mbledhjen e datës 09.09.2019 ka vendosur pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve (20.09.2019) për plotësimin e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë shprehur interesin 4 kandidatë. Pas paraqitjes zyrtare të listës me renditjen e kandidatëve për ILD, Kuvendi do të vijojë me ushtrimin e kompetencës sipas parashikimeve dhe afateve ligjore.</p> <p>MD: Në vijim të punës për hartimin e kësaj mase, nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë është hartuar vendimi ‘Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe</p>
---	------------------------------	--	---------------	--	--	--	------------------	---

								<i>kritereve ligjore, verifikimin e figurës dhe pasurisë së kandidatëve jomagjistratë’, i cili është miratuar me Vendimin nr.536, datë 25.07.2019 të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 110, datë 29.07.2019.</i>
2. Hartimi dhe publikimi i standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes për magjistratët si dhe monitorimi i zbatimit të tyre.	KLD/KLGJ/ KLP	Kryerja e studimit të nevojshëm dhe përgatitja e draftit. Diskutim, miratim dhe publikim nga KLGJ e KLP; Emërimi i një magjistrati në cilësinë e këshilltarit të etikës.	17 250	17 250			Në proces	KLJGJ: Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e rregullave dhe kodit të etikës dhe për monitorimin e tyre, dhe specifikisht Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, po konsideron me prioritet përgatitjen e draftit të parë të standardeve të etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, sipas Ligjit nr. 115/2016. Me vendimin nr. 208, datë 11.10.2019, KLGJ caktoi një gjyqtar si këshilltar për etikën. KLP: Nuk ka ende zhvillime për periudhën e raportimit.
3. Hartimi i bazës nënligjore mbi procedurat dhe kriteret e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave të propozuara disiplinore ndaj gjyqtarëve e prokurorëve.	KLJGJ KLP	Kryerja e studimit të nevojshëm dhe përgatitja e draftit. Diskutimi dhe miratimi nga KLGJ e KLP. Zbatimi i procedurave		7 500			Në proces	KLJGJ: Kuadri ligjor mbi definimin e shkeljeve disiplinore (Ligji 48/2019) u miratua së fundmi (datë 18/07/2019). Kjo i hap rrugë procesit të hartimit të akteve nënligjore dhe rregulloreve për shqyrtimin dhe vlerësimin e masave të propozuara disiplinore ndaj gjyqtarëve. KLP: Me miratimin e Ligjit nr. 47/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u shtuan 3 dispozita, lidhur me shkeljet disiplinore të anëtarëve të KLP, sikurse u bë një ndarje e shkeljeve disiplinore, sipas natyrës së tyre në: a) shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit;

								<p>b) shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit;</p> <p>c) shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale.</p> <p>Nuk ka nisur ende hartimi akteve nënligjore për procedurat dhe kriteret e shqyrtimit dhe vlerësimit të masave disiplinore ndaj prokurorëve.</p>
4. Përmirësimi i transparencës së procesit të vlerësimit të masave disiplinore.	KLJGJ	<p>Hartimi i një rregulloreje të brendshme mbi transparencën e vlerësimit të masave disiplinore.</p> <p>Anonimizimi dhe publikimi në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve.</p>	8 000	3 750			Në proces	<p>Zbatimi i kësaj mase varet edhe nga zbatimi i masës së mësipërme.</p> <p>Rregullorja e brendshme e KLJGJ mbi transparencën e vlerësimit të masave disiplinore gjithashtu pritet të përfundojë deri në dhjetor 2019.</p>
5. Reduktimi i vonesave në vlerësimin vjetor periodik të magjistratëve.	KLJGJ	<p>5 vjet vonesë (backlog)</p> <p>(periudha kohore mes vitit kur kryhet faktikisht vlerësimi periodik me vitin për të cilin kryhet vlerësimi)</p>	57 150				Në proces	<p>KLJGJ (Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale) po punon për hartimin e skemës së re të vlerësimit të gjyqtarëve, që siguron plotësimin në kohë dhe reduktimin e numrit të çështjeve të mbartura;</p> <p>Në planifikimin afatshkurtër është edhe hartimi i një dokumenti politikash që do të mundësojë shqyrtimin e të gjitha atyre vlerësimeve që nuk janë realizuar brenda kuadrit të mëparshëm ligjor;</p>

Objektivi 2: Konsolidimi i arsimit dhe formimit ligjor si edhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave
Nën-objektivi 2/a: Kualifikimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit të gjykatës sipas standardeve/kërkesave evropiane

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Thellimi dhe zgjerimi i aktivitetit të Shkollës së Magjistraturës në drejtim të rekrutimit dhe ofrimit të programeve trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët si dhe kategoritë e tjera të personelit të gjykatave dhe prokurorive nëpërmjet përmirësimit të programit të rekrutimit dhe kurrikulave për kandidatët për magistratë, si dhe krijimi i kurrikulave të reja dhe moduleve të trajnimit për kategoritë e tjera.	SHM	<p>Krijim kurikula kancelarë.</p> <p>Përmirësim i programit të rekrutimit dhe kurrikulës për lëndët e vitit të parë për formimin fillestar për kandidatët magistratë dhe krijimi i moduleve të trajnimit per programin e formimit vazhdues për kancelarë.</p> <p>Miratimi i metodologjisë për tre komponentët (cilësia e kurrikulave, personelit dhe trajnimit të vazhdueshëm)</p>		2 681			E realizuar	<p>Këshilli pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, në bashkëpunim me Misionin Euralius V, u angazhua në përmirësimin e programit të provimit të pranimit të kandidatëve për magistratë dhe kandidatëve për këshilltarë e ndihmës ligjorë. Ndryshimet konsistonin në anën strukturore të pyetjeve të testimit dhe përditësimin e programit të provimit të pranimit me ligjet e ndryshuara. Në fund të muajit shtator, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës miratoi kurrikulën e re për lëndët e vitit të parë të programit të formimit fillestar për kandidatët për magistratë dhe kandidatët për këshilltar e ndihmës ligjorë.</p> <p>Në bashkëpunim me Projektin Drejtësi për të Gjithë të USAID është krijuar kurrikula për formimin profesional fillestar të kancelarëve, të trajnuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit. Kurrikula përshin 14 module të cilat ofrojnë udhëzime gjithëpërfshirëse në fushat e përgjegjësive funksionale që lidhen me administrimin e gjykatave, si dhe aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale të nevojshme për të udhëhequr reformën në gjyqësor. Mbulimi financiar i të gjithë projektit është bërë nga EWMI, Justice For All.</p>

<p>2. Transformimi gradual i Shkollës së Magjistraturës në një qendër burimore dhe drejtën e Bashkimit Evropian dhe të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ofrimi i kushteve optimale të trajnimit për magjistratët dhe personelit të gjykatave. Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore për Shkollën e Magjistraturës.</p>	<p>KLJGJ, SHM</p>	<p>Përshtatja e ambienteve të Shkollës në rast zhvendosjeje.</p> <p>Procedura e prokurimit për ndërtimin e godinës së re (me të paktën 10 klasa) dhe fillimi i punimeve.</p>	<p>798 345</p> <p>306 345 ('19)</p> <p>246 000 ('20)</p> <p>246 000 ('20)</p>				<p>Në proces</p>	<p>Shkolla e Magjistraturës në muajin tetor është zhvendosur pjesërisht, përkohësisht, në ambiente të reja, të cilat kur të përfundojnë së rishtrukturuari, pritet t'i plotësojnë kërkesat për zhvillimin normal të programit të formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe kandidatëve për këshilltar e ndihmës ligjorë, kancelarëve, avokatëve të shtetit, gjithashtu dhe të nevojave të programit për trajnim të vazhduar të magjistratëve në detyrë. Në këto ambiente do i jepet zgjidhje e përkohëshme edhe nevojave për hapësira më të përshtatshme pune për stafin akademik dhe administrativ të Shkollës. Me VKM nr.234, dt. 17.04.2019, Shkolla e Magjistraturës do të ushtrojë veprimtarinë e saj në të njëjtën godinë me KLGJ dhe KLP. Për periudhën Janar-Shtator 2019 nuk ka asnjë kosto nga ana e Shkollës.</p> <p>Në vijim të procedurave për ndërtimin e godinës së re të Shkollës së Magjistraturës, në respektim të afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur me studion projektuese, në qershor të vitit 2019 duhet të dorëzohej pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), Projekti i Zbatimit për ndërtimin e saj. Lidhur me zbatimin e kësaj kontrate SHM është vënë në dijeni nga AKPT me shkresën nr. 673/06 prot, datë 26.6.2019, "Për zgjatjen e afatit, të zbatimit të kontratës së shërbimit me objekt "Projekti i zbatimit për ndërtimin e Shkollës së Magjistraturës" deri në dhjetor 2019, si dhe nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 4647/2 prot., datë 24.7.2019, "Mbi vijueshmërinë e punës në zbatim të vendimit nr. 234, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për programin e integruar të zhvillimit "Poli i Drejtësisë", me anë të së</p>
---	-------------------	--	---	--	--	--	------------------	--

							<p>cilës sugjeron vijimin e punës dhe mundësinë e përdorimit të projektit të zbatimit të hartuar deri më tani nga studio projektuese, për ndërtimin e godinës së Shkollës së Magjistraturës, në përshtatje me terrenin e ri në dispozicion të kampusit të ri “Poli i Drejtësisë”.</p> <p>KLJGJ: Mendojmë të rishikohet KLJGJ si institucion përgjegjës, pasi në bazë të ligjit nr. 115/2016 “për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara në ligj; KLJGJ nuk mendojmë që ka rol as në përshtatjen e ambienteve të shkollës dhe as në procedurat e prokurimit (<i>dy target për vitin 2019</i>).</p> <p>Për sa i përket bashkëpunimit mes KLJGJ dhe SHM, vlen të theksohet që KLJGJ ka dhënë opinion në mbledhjen plenare të datës 2 korrik për draft programin tematik 2019-2020 të SHM, si dhe kurrikulat e trajnimit 8 javor për kancelarët e gjykatave.</p>
3. Rritja dhe përmirësimi i punës kërkimore shkencore nëpërmjet pasurimit të fondit të bibliotekës dhe sigurimi i aksesit në bibliotekat digjitale.	SHM	<p>Botime shkencore</p> <p><i>E-commentary.</i></p> <p>100 libra literature vendase dhe të huaj, botime</p>	<p>6 048;</p> <p>2 170 ('19);</p> <p>1 939 ('20);</p> <p>1 939 ('21)</p>		635 (mijë lekë)		<p>Në proces</p> <p>Shkolla e Magjistraturës ka botuar 3 numra të Revistës “Jeta juridike”, konkretisht nr. 3 të vitit 2018, nr. 1 të vitit 2019 dhe nr.2 të vitit 2019, me nga 300 kopje për secilin numër. Nën kujdesin e Shkollës së Magjistraturës janë botuar dy tituj shkencorë, njëri në fushën e të drejtës procedurale penale dhe tjetri në të drejtën civile. Shpenzimet për këto dy botime janë mbuluar nga vetë autorët.</p> <p>Komentari elektronik është një platformë e krijuar dhe zhvilluar nga Misioni Euralius ku tashmë janë komentuar 247 dispozita të ligjeve të reformës në drejtësi nga Misioni.</p>

					36 (mijë lekë)		<p>Aktualisht, platforma mbahet fizikisht në serverin e SHM dhe është e aksesueshme pa pagesë. Komentari elektronik synon të shoqërojë zbatimin e plotë të reformës në drejtësi, duke futur në vend në të njëjtën kohë një kulturë të re akademike të ngjashme me atë të vendeve evropiane që ka të bëjë me një analizë të thellë dhe të plotë të dispozitave ligjore. E gjithë kjo ndërmarrje mbështetet financiarisht dhe me ekspertizë teknike nga Fondacioni IRZ. Aktualisht, është në proces marrja në dorëzim e platformës nga Shkolla e Magjistraturës.</p> <p>Deri më tani është investuar në pasurimin e bibliotekës së Shkollës. Koncretisht, fondi i Bibliotekës së Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Janar-Shtator 2019, është rritur me 85 njësi bibliotekare, nga të cilat 50 njësi janë monografi në fushën e jurisprudencës, 15 tema të kandidatëve për magjistratë të vitit të dytë dhe 10 seriale.</p>
4. Trajnime dhe kualifikime për ngritjen e kapaciteteve këshilluese të vendimmarrjes dhe të stafit nëpunës civil në lidhje me zgjerimin e juridiksionit të GJK, të miratuar në kuadër të reformës në drejtësi.	GJK	<p>Seanca trajnimesh për gjyqtarë;</p> <p>Seanca trajnimesh për staf/personel.</p> <p>Analiza e nevojave për trajnim për këshilltarët aktualë dhe të rinj; Seanca trajnimi për: aspektet e reja të juridiksionit</p>	23 700			E paraportuar	

		të GJK (për gjyqtarë dhe për personel)						
Objektivi 3: Përmirësimi i funksionimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen në gjykatë në përputhje me standardet evropiane Nën - objektivi 3/a: Përmirësimi i transparencës në funksionimin e sistemit gjyqësor (Shënim: masat në lidhje me efikasitetin janë përfshirë nën Objektivin 1b)								
Indikatori / Treguesi: % e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është i aksesueshëm online dhe i përditësuar								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Rritja e marrëdhënieve të gjykatave me median dhe sigurimi i qasjes së publikut në informacione për rastet me interes publik.	KLJGJ	Ngritja e strukturave të magistratëve që do të kenë në përgjegjësi marrëdhëniet me median.	500	4 000			Në proces	KLJGJ, me vendimin nr. 68 datë 24.04.2019, ka përcaktuar anëtarin për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun. Gjithashtu, KLJGJ me Urdhrin nr. 19 datë 09.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, ka miratuar “Programin e Transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Publikimi elektronik në kohë i vendimeve të gjykatave si dhe analizave vjetore të gjykatave / raporte efijence dhe përditësimi i rregullt i faqes gjykata.gov.al.	KLJGJ	Zbatimi në varësi të përmirësimit dhe konsolidimit të sistemit të informatizuar dhe të faqes web. Sigurimi i mirëmbajtjes së nevojshme të infrastrukturës së sistemit elektronik që është përgjegjëse për “uplink” në faqen gjykata.gov.al	18 000				E përealizuar	Zbatimi i kësaj mase kërkon një analizë të thelluar të kapaciteteve teknike të faqes gjykata.gov.al, si dhe të burimeve njerëzore në gjykata.

Nën-objektivi 3/b: Përmirësimi i aksesit në sistemin e drejtësisë

Indikatori / Treguesi:

% e aplikantëve që plotësojnë kushtet ligjore të cilët përfitojnë shërbimin e ndihmës ligjore dytësore falas.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) është krijuar dhe ka funksionalitet të plotë.	MD	Rregullore të përfunduara; Stafi kyç i emëruar; DNJF është plotësuar me staf; Përfundimi i procesit të hartës kombëtare dhe dakordimi i strukturës së ofruesve të shërbimit. Kalendar i mbajtur për fushatat ndërgjegjëse ;	86 500				Në proces	Në zbatim të ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” janë hartuar dhe miratuar aktet e poshtëshënuara nga Këshilli i Ministrave: 1. Vendimi nr.110 datë 06.03.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”; 2. Vendimi nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”; 3. Udhëzimi nr. 1, datë 6.3.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.
								Ministri i Drejtësisë ka miratuar aktet

							<p>nënligjore në zbatim të ligjit 111/2017:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi nr.1 datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”; - Udhëzimi nr.2 datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”; - Urdhri nr.225 datë 25.3.2019 "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti"; - Urdhri nr.226 datë 25.3.2019 "Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti"; - Udhëzimi nr.6 datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave dhe e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”. <p>Është miratuar struktura dhe organika e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 59, datë 25.03.2019). Numri total i punonjësve, sipas strukturës, është 25. Aktualisht DNJF ka 5 nëpunës staf dhe 7 punonjës të tjerë kanë fituar si rezultat i procesit të konkurimit në DAP. Gjatë muajit tetor pritet të fillojë plotësimi i këtyre vakancave.</p> <p>Ministria e Drejtësisë në përmbushje të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, si dhe në kuadër të nismës së mbështetura nga OSFA, për hapjen e qendrave të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, ka marrë përsipër ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, nëpërmjet hapjes së dy</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>qendrave të para të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</p> <p>Ministria e Drejtësisë fillimisht me Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Elbasan kanë rënë dakord për hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore pranë ambienteve ku ofrohen shërbimet me qytetetarët. Këto bashki kanë ofruar mjediset e tyre për qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, ndërkohë që në bashkëpunim midis tyre do të caktohen burimet njerëzore profesionale për mbarëvajtjen e punës së këtyre dy qendrave.</p> <p>Në secilën prej këtyre qendrave do të ofrojnë shërbime dy ekspertë.</p> <p>Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Elbasan, lidhur me vënien në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të zyrës së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore. Gjatë muajit tetor 2019 pritet hapja dhe funksionimi i kësaj qendre.</p>
2. Sistemi i Ndihmës Juridike Parësore ka funksionalitet të plotë.	DNJF	<p>Janë zhvilluar fushata ndërgjegjësuese ;</p> <p>Plotësimi i kuadrit nënligjor (pika 1);</p> <p>Janë ngritur/krijuar 4 zyrat e para rajonale;</p>					<p>Në lidhje me realizimin e kësaj mase nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë, në zbatim të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, për periudhën Janar-Shtator 2019 janë hartuar vendimet dhe udhëzimet si më poshtë të miratuara nga Këshilli i Ministrave:</p> <p>1. Vendimi nr.110 datë 06.03.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të</p>

		<p>Mbulohen të paktën 60% e nevojave për ndihmë parësore në shkallë vendi;</p> <p>Janë ngritur/krijuar 4 zyra rajonale shitesë;</p> <p>Rekrutim dhe trajnim i punonjesve me trajnim të posaçëm;</p> <p>Publikimi i listës së OJF-të autorizuar në përfundim të procedurës ligjore (thirrje, shqyrtim, dhënie vendimi);</p> <p>Ngritja dhe funksionimi i klinikave ligjore pranë 4 universiteve që kanë fakultet juridik TR, DR, VL dhe SHK;</p> <p>Janë zhvilluar fushata ndërgjegjësuese</p>	29 000		0		<p>Në proces</p> <p>autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;</p> <p>2. Vendimi nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;</p> <p>3. Udhëzimi nr. 1, datë 6.3.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.</p> <p>Ministri i Drejtësisë ka miratuar aktet nënligjore në zbatim të ligjit 111/2017:</p> <p>i. Udhëzimi nr.1 datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”;</p> <p>ii. Udhëzimi nr.2 datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”;</p> <p>iii. Urdhri nr.225 datë 25.3.2019 "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti";</p> <p>iv. Urdhri nr.226 datë 25.3.2019 "Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti";</p> <p>v. Udhëzimi nr.6 datë 20.08.2019 “Për</p>
--	--	---	--------	--	---	--	--

		;						<p>rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave dhe e shpenzimeve gjyqsore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”.</p> <p>Është miratuar struktura dhe organika e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 59, datë 25.03.2019). Aktualisht DNJF ka 5 nëpunës staf dhe 7 punonjës të tjerë kanë fituar si rezultat i procesit të konkurimit në DAP. Gjatë muajit tetor pritet të fillojë plotësimi i këtyre vakancave.</p> <p>Ministria e Drejtësisë në përmbushje të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, si dhe në kuadër të nismës së mbështetura nga OSFA, për hapjen e qendrave të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, ka marrë përsipër ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, nëpërmjet hapjes së dy qendrave të para të shërbimit të ndihmës juridike parësore.</p> <p>Ministria e Drejtësisë fillimisht me Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Elbasan kanë rënë dakord për hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore pranë ambienteve ku ofrohen shërbimet me qytetetarët. Këto bashki kanë ofruar mjediset e tyre për qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, ndërkohë që në bashkëpunim midis tyre do të caktohen burimet njerëzore profesionale për mbarëvajtjen e punës së këtyre dy qendrave.</p> <p>Në secilën prej këtyre qendrave do të ofrojnë shërbime dy ekspertë.</p> <p>Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar</p>
--	--	---	--	--	--	--	--	--

							<p>marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Elbasan, lidhur me venien në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të zyrës së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore. Gjatë muajit tetor 2019 pritet hapja dhe funksionimi i kësaj qendre.</p> <p>Klinikat Ligjore janë të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL) dhe ofrojnë ndihmë juridike parësore.</p> <p>Në vijim, pas krijimit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, kjo drejtori do të bashkëpunojë me klinikat ligjore nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.</p> <p>Aktualisht funksionojnë këto Klinika, përkatësisht, Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës (FDUT), Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD), Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Universiteti “Luarasi” Tiranë dhe “Universiteti Europian i Tiranës”.</p> <p>Përsa i përket fushatave ndërgjegjësuese, Zyra e Ndhmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë ka bërë të mundur dhënien e informacioneve të nevojshme për çdo qytetar që i është drejtuar kësaj zyre.</p> <p>Ndërgjegjësimi i qytetarëve përsa i përket zbatimit të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, është bërë dhe nëpërmjet dhënies së intervistave pranë</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								televizioneve dhe radiove të vendit. Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë janë zhvilluar takime pranë Fakultetit të Drejtësisë përsa i përket njohjes dhe zbatimit të ligjit nga studentët e drejtësisë.
3. Sistemi i Ndhmës Juridike Dytësore ka funksionalitet të plotë.	DNJF; Gjykatat; DHKA; SHM	Plotësimi i kuadrit nënligjor (pika 1); Përzgjedhja e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë dytësore dhe publikimi i listës; Trajnimi i gjyqtarëve; Trajnimi i avokatëve që ofrojnë ndihmë dytësore; Të paktën 40% e nevojave kombëtare janë përmbushur (me buxhet të mjaftueshëm për Ndhmën Dytësore); nga këto, të paktën 40% e nevojave të grupeve vulnerabel; Janë zhvilluar	135 000		7 741 (mijë lekë) (DNJF)		Në proces	MD: Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe udhëzimet dhe urdhrat e mëposhtme të miratuara nga Ministri i Drejtësisë: 1. Udhëzimi nr.1 datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”; 2. Udhëzimi nr.2 datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”; 3. Urdhri nr.225 datë 25.3.2019 "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti"; 4. Urdhri nr.226 datë 25.3.2019 "Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti"; 5. Udhëzimi nr.6 datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave dhe e shpenzimeve gjyqsore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike”. Të cilat gjenden të publikuara në linkun e mëposhtëm: https://drejtesia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/ Gjithashtu janë në fazën e vlerësimit dhe miratimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dy projekt udhëzime ku sipas, Nenit 34, pika 6, i ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organ i

		fushata ndërgjegjësuere					<p>ngarkuar për miratimin e akteve nënligjore të poshtë shënuara:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. projekt udhëzimi “Për rregullat e caktimit mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal”; dhe 2. projekt udhëzimi “Për rregullat për garantimin e mbrojtjes së detyrueshme”, i Prokurorisë. <p>Aktualisht mbeten edhe tre projektakte nënligjore, të pa miratuara:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Projektudhëzimi i përbashkët me DHASH “Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore”; 2. Projektudhëzim i përbashkët me MFE “Kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifave përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, i cili është dërguar për kontribut Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë përpara dërgimit pranë MFE -së sipas përcaktimit ligjor; 3. Projekt urdhri “Për kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”; <p>Këto projektakte janë të hartuara nga ana e grupit të punës dhe jemi në proces bashkërendimi me institucionin e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë.</p>
--	--	----------------------------	--	--	--	--	---

							<p>Ndërkohë edhe pse ende aktet nënligjore nuk kanë dalë, Dhoma Kombëtare ka përgatitur listat për ndihmën juridike dytësore, referuar ligjit 111/2017 “Për ndihmën juridike dytësore”, të renditura sipas rendit të aplikimit të procedurës së rotacionit. Listat janë dërguar edhe pranë dhomave vendore të avokatisë për zbatimin sipas parimit të rotacionit. Një pjesë e rretheve nuk kanë dërguar për mungesë vullneti të aplikimit. Për këto rrethe është vendosur që t’i caktoj DHASH.</p> <p>Përsa i përket fushatave ndërgjegjësuese, Zyra e Ndihmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë ka bërë të mundur dhënien e informacioneve të nevojshme për çdo qytetar që i është drejtuar kësaj zyre.</p> <p>Ndërgjegjësimi i qytetarëve përsa i përket zbatimit të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, është bërë dhe nëpërmjet dhënies së intervistave pranë televizioneve dhe radiove të vendit.</p> <p>Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë janë zhvilluar takime pranë Fakultetit të Drejtësisë përsa i përket njohjes dhe zbatimit të ligjit nga studentët e drejtësisë.</p> <p>DNJF: Për periudhën Janar – Shtator 2019 është dhënë ndihmë juridike dytësore në vlerën 7 741 000 lekë.</p> <p>SHM: Shkolla e Magjistraturës miraton në çdo muaj shtator të vitit, kalendarin e trajnimeve të një viti akademik. Për vitin akademik Tetor 2018 – Korrik 2019, ishin parashikuar dhe u realizuan 3 (tre) trajnime për gjyqtarë, në datat 19, 20 dhe 21 nëntor 2018 me temë “Për ndihmën juridike të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

49.5
(mijë
lekë)
(SHM)

								garantuar nga shteti”. Në këto trajnime morën pjesë 24 gjyqtarë. Njëkohësisht, kjo tematikë është përfshirë në kalendarin e trajnimeve për vitin akademik 2019-2020, në datën 20-21 nëntor 2019. (Masë e realizuar për Shkollën e Magjistraturës)
Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave antikorrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale								
Nën-objektivi 4/a: Përmirësimi i efikasitetit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë penale sipas standardeve evropiane								
Indikatori / Treguesi:								
% e rasteve të paraburgimit në lidhje me krime me rrezikshmëri të ulët (parashikimi i denimit me burgim deri në 5 vjet); dhe % e uljes së numrit të të miturve në paraburgim (vlera të ndara).								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1.Monitorimi i rasteve të paraburgimit për vepra të vogla si dhe të numrit të të miturve në paraburgim (nga procesi i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarëve dhe procesi disiplinor).	KLJGJ	Identifikimi vjetor i rasteve, analiza në nivel makro dhe nxjerrja e rekomandimeve për institucionet përkatëse.	1 800				E përealizuar	Promovimi i përdorimit të masave alternative të dënimeve nga gjykatat, parashikon miratimin nga ana e KLGJ të një akti nën-ligjor “Për përdorimin e masave alternative të dënimit nga gjykatat”, sipas parashikimeve të Planit Strategjik të KLGJ 2019-2020 (Vendimi Nr.126 datë 19.07.2019).
2.Nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme që synojnë: a) Rritjen e efikasitetit të hetimit;	PP	Studim i kuadrit ligjor dhe situatës aktuale dhe hartimi i drafteve që adresojnë gjetjet. Identifikimi i gjendjes dhe statistikave aktuale.					Në proces	Në kuadrin e ushtrimit të kompetencave Kushtetuese e ligjore në funksion të rritjes së efikasitetit, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerr aktet normative si më poshtë: - Udhëzimi i Përgjithshëm nr.3 datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore” - Udhëzimi i Përgjithshëm nr.2 datë 24.05.2019 “Për zbatimin e ligjit lidhur me regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë”;

<p>b) Rritjen e aplikimit të masave të sigurimit të ndryshme nga masa me arrest në burg për veprat penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore (deri në 5 vjet burgim)</p>		<p>Draftim, diskutim dhe miratim i akteve nënligjore.</p> <p>Rritja 2 % e çështjeve dërguar në gjykatë për vepra me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në krahasim me statistikat e vitit 2017.</p> <p>Rritja 5 % e kërkesave të prokurorit për masa alternative sigurimi të ndryshme nga ajo me burg, krahasuar me statistikat e vitit 2017</p>	<p>2 000</p>					<p>- Urdhri nr.101, datë 12.06.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për emërimin e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”;</p> <p>- Është miratuar udhëzimi i përgjithshëm “Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, punuar në bashkëpunim me ekspertët e Euralius-it.</p> <p>Pa kosto shtesë për PP.</p>
<p>3. Garantimi i kushteve të punës sipas standardeve bashkëkohore nëpërmjet:</p> <p>a) Shtimi i stafit mbështetës në funksion të prokurorit;</p>	<p>PP, KLP</p>	<p>Analiza e nevojave;</p> <p>Përgatitja e statistikave mbi ngarkesën mesatare (baseline 2018).</p>	<p>205 900;</p> <p>për n/masën e ndarë:</p> <p>a)192 000;</p> <p>c) 13 900</p>	<p>99 385; për n/masën b) e ndarë;</p> <p>b) 2 085: 97 300</p>	<p>(a)18 245 (mijë lekë)</p> <p>(b) 2 195 (mijë lekë)</p>		<p>E realizuar</p>	<p>PP: a) Sipas Ligjit Nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, prokurorisë i janë shtuar 65 punonjës.</p> <p>Janë rekrutuar gjatë periudhës raportuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 27 oficerë të policisë gjyqësore; - 23 koordinatorë të viktimave; - 14 sekretare; - 1 IT; - 1 këshilltar. <p>Të gjitha këto emërimet janë bërë në muajin Korrik 2019. Për shtesën në organik prej 65 punonjësish PP nuk ka kërkuar në PBA 2018-2020 fonde për shpenzime personeli.</p>

<p>b) Investime në infrastrukturë; Ndërtime të reja; Rikonstruksion;</p> <p>c) Trajnimi vazhdues i oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit të nëpunësve civilë.</p>	<p>PP</p>	<p>Rekrutimi dhe trajnim i punonjësve;</p> <p>Realizimi i investimeve;</p> <p>Trajnim vazhdues profesional</p>						<p>Në kuadër edhe të rritjes së pagave të magistratëve dhe oficerëve, ky fond është çelur gjatë vitit 2019.</p> <p>b) Rikonstruksion i pjesshëm (realizuar plotësisht në Prokurorinë e Apelit Vlorë dhe në Prokurorinë Përmet. Mbetet pa realizuar shtesa e katit e parashikuar për Prokurorinë e Rrethit Gjirokastrë.</p> <p>c) Gjatë periudhës raportuese projekti Pameca V ka zhvilluar 5 trajnime me pjesëmarrës 40 oficerë të policisë gjyqësore. Pa kosto shtesë për PP.</p> <p>- Gjatë periudhës raportuese nëpunësit civil kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga ASPA: 3 trajnime për punonjësit e rinj në periudhë prove (të çertifikuar të tre). 14 trajnime për specialistë të fushave të ndryshme.</p> <p>Pa kosto shtesë për PP.</p> <p>KLP: KLP është në proces rekrutimi të stafit. Me vendimin nr. 150, datë 22.07.2019, janë miratuar detyrat e administratës së KLP dhe kanë filluar procedurat e rekrutimit sipas ligjit për nëpunësin civil.</p> <p>Nuk janë zhvilluar ende trajnime të punonjësve, gjatë kësaj periudhe.</p> <p>Nuk janë kryer ende investime për periudhën e raportimit.</p>
<p>4. Rritja e efencës së përgjimeve në procesin penal,</p>	<p>PP</p>	<p>Analiza e nevojave.</p>		<p>232 130</p>			<p>Në proces</p>	<p>a) Lidhur me procesin e decentralizimit të përgjimeve, nga ana e PP është kryer analiza për nevojat dhe mënyrën e</p>

nëpërmjet: a) Realizimi i procesit te decentralizimit të përgjimit të komunikimeve elektronike pranë prokurorive; b) Zgjerimi i kapaciteteve për përgjimin aktiv.		Përcaktimi i statistikave për normën e dënimit në çështjet ku është përdorur përgjimi (2018 baseline). Instalohen mjetet teknike në 8 prokurori të shkallës së parë dhe trajnohet stafi						lidhjes teknike (remote offices). b) Gjatë periudhës raportuese është zhvilluar një workshop për përgjimin aktiv (trajan technology), ku morën pjesë 5 Oficerë të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Përgjimeve. Pa kosto shtesë për PP
---	--	--	--	--	--	--	--	--

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar procedurat dhe lehtësirat moderne të sistemeve elektronike për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar

Nën-objektivi 5/a: Përmirësimi i gjyqësorit përmes futjes së sistemeve IT të administrimit dhe përmirësime të tjera në infrastrukturë

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Krijimi i një platforme të unifikuar IT për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit. (përfshirë platforma për menaxhimin e çështjeve) (Në funksion dhe të objektivit 1a)	KLJGJ	Përmirësimi i operacioneve të TI dhe shërbimet mbështetëse për sistemet elektronike në gjyqësor; Përmirësimi informacionit statistikor të ofruar nga sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore si një		469 350			Në proces	Në kushtet aktuale, kur ende është në diskutim mënyra dhe forma e menaxhimit të sistemeve elektronike të gjyqësorit, arritja e këtij objektivi nuk mund të jetë i mundur në vitin 2019. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dhënë opinionin e tij në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e qendrës së IT dhe në vijim janë zhvilluar edhe takime konsultative me partnerë ndërkombëtarë (Euralius dhe JUST/USAID).

		zgjdhje e përkohshme derisa ICMIS të jetë funksionale					
2. Krijimi i qendrës së centralizuar të mbështetjes së funksionimit të TIK (ITOSC) që do të qeverisë sistemet TIK të gjykatave, KLGJ, KLP, ILD.	MD, KM, Qendra TIK	Miratimi i VKM për ngritjen e Qendrës TIK. Vënia në funksion e Qendrës TIK; Rekrutimi i burimeve njerëzore e teknike të Qendrës; Trajnimi i kapaciteteve teknike të Qendrës;	70 803				Në proces MD: Në lidhje me realizimin e kësaj mase, nga ana Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë është hartuar projektvendimi “Për krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe politikat e përgjithshme shtetërore për sistemin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”. Aktualisht projektvendimi i është nënshtruar procesit të konsultimit të brendshëm (ministritë e linjës dhe organe të administratës publike), janë mbajtur takime me përfaqësues të Euralius, me të cilët është dakordësuar një draft dhe janë përcjellë sugjerimet përkatëse në lidhje me të. Drafti është ripunuar në vijim të komenteve dhe pritet të përcillet për bashkërendim drejtuar institucioneve DAP, AKSHI-t dhe MFE-së e më pas dërgimin e tij për shqyrtim dhe miratim pranë KM.
3. Blerje dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike për gjykatat	KLJGJ, Gjykatat	<u>95%</u> ¹⁷	175 000		25,940 (mijë lekë)		E realizuar Për periudhën janar-shtator 2019, 35 gjykata e kanë realizuar investimin për blerjen e pajisjeve elektronike. 1 gjykatë është në proces prokurimi.

¹⁷ Për vitin 2019, 95% - nënkupton që nga 38 gjykata, 95% e tyre i kanë të gjitha pajisjet elektronike (100%) në gjendje të mirë pune. Pajisjet elektronike kanë % të lartë amortizimi, për këtë arsye çdo vit nevojitet të investohet për rinovim dhe plotësim të nevojave të reja. Vlera e plote e investimeve të planifikuara për infrastrukturen elektronike në gjykata për periudhën 2019-2021, është në total rreth 175,000 mijë lekë. Në këtë vlerë nuk janë përfshirë nevojat për programin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

<p>4. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (KLGJ/ILD/KLP)</p> <p>4.1. Pajisja e organeve të reja të drejtësisë me infrastrukturën elektronike të nevojshme (SPAK/GJKKKO)</p>	<p>KLGJ, KLP, ILD</p> <p>SPAK/GJKKKO</p>	<p>Vendosja/instalmi i pajisjeve IT dhe vënia në funksion e tyre.</p> <p>Sistemi (software) i menaxhimit të brendshëm i zhvilluar (i veçantë për çdo institucion).</p> <p>Vendosja/instalmi i pajisjeve IT dhe vënia në funksion e tyre.</p> <p>Sistemi i brendshëm (softi) i menaxhimit të brendshëm i zhvilluar.</p> <p>(i veçantë për çdo institucion)</p>	<p>110 308,</p> <p>KLGJ 43 515,</p> <p>KLP 44 640</p> <p>ILD 22 153</p> <p>234 675;</p> <p>SPAK 227 970;</p> <p>GJKKKO 6 705</p>	<p>2,532 (mijë lekë) (KLP)</p>	<p>Në proces</p>	<p>KLGJ: Në varësi edhe të sistemimit në ambiente të reja.</p> <p>KLP: Ndihmë/ Dhuratë nga Ambasada Amerikane (OPDAT) në pajisje elektronike si: printer, laptop, server, UPS server dhe skaner.</p> <p>Për shkak të mos-konstituimit të SPAK/GJKKKO.</p>
<p>5. Investim sipas standardeve bashkëkohore në godinat e gjykatave</p>	<p>KLGJ, Gjykatat</p>	<p><u>58%</u>¹⁸</p>	<p>352 000</p>		<p>E përealizuar</p>	<p>Investimet e plota në infrastrukturën ndërtimore janë planifikuar të fillojnë në vitin 2020. Kjo lidhet me miratimin e hartës së re gjyqësore, që është në proces.</p>
<p>6. Përmirësimi i sistemit elektronik të</p>	<p>PP</p>	<p>Analiza e detajuar;</p>	<p>40 230</p>		<p>Në proces</p>	<p>Përmirësimi i funksionaliteve eksistuese të sistemit, si dhe përfundimi i ndërlikjes së</p>

¹⁸ Në vitin 2019, kemi 22 godina gjykatash që janë ndërtime të reja apo godina të rikonstruara plotësisht ose 58% e gjykatave (22/38 gjykata). Miratimi i hartës së re gjyqësore, kushtëzon investimet në godina. Investim i plotë është planifikuar të realizohet në dy godina gjykatash (1 ndërtim, 1 rikonstruksion i plotë) dhe do të shtrihet në dy vite buxhetore, 2020-2021. Vlera totale e investimit për të dy godinat është rreth 352,000 mijë lekë. Me përfundimin e investimit për këto gjykata, në vitin 2021, % do të ndryshojë nga 58 në 63% (24 godina të reja dhe/ose të rikonstruara /38 gjykata në total).

<p>menaxhimit të çështjeve në prokurori, duke reflektuar në të edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe trajnimi i stafit</p>		<p>Sistemi është plotësisht funksional.</p>						<p>sistemit CAMS me sistemin e Policisë së Shtetit.</p> <p>Gjatë vitit 2019 është bërë e mundur ndërlidhja me sistemin e Policisë së Shtetit. Janë bërë edhe trajnimet e nevojshme të nëpunësve të zyrës së regjistrimit mbi këtë modul dhe së shpejti (jemi në proces të blerjes së serverave të duhur) do të vendoset në funksionim.</p> <p>Moduli i apeleve është përfunduar por gjatë testimeve me këtë modul janë hasur problematika të cilat janë duke u riparuar nga kompania implementuese.</p> <p>Gjithashtu vlen të përmendim se moduli i statistikave vazhdon të mbetet në testim, kjo për shkak edhe të ndryshimeve dhe riparimeve të herëpashershme që kompania në bashkëpunim me drejtorinë e IT kryen në sistem.</p> <p>Nga analiza përfundimtare e këtij sistemi nga ana e Drejtorisë IT në Prokurorinë e Përgjithshme, në raport me kërkesat e Kontratës, disa nga pikat e kësaj kontrate janë ende të papërbushura dhe aktualisht kompania është duke punuar për finalizimin e tyre. Gjithashtu, kompania po riparon në bashkëpunim me departamentin e IT-së së prokurorisë defekte të ndryshme që lindin si pasojë e implementimeve që bëhen në sistemin CAMS.</p> <p>Pa kosto shtesë për PP, pasi projekti financohet nga IPA.</p> <p>Kërkesat e reja që kanë lindur si pasojë e ndryshimeve ligjore janë të draftuara dhe kanë nevojë për financim.</p>
---	--	---	--	--	--	--	--	--

7. Krijimi i kanaleve të sigurta të komunikimit për shkëmbimin e informacionit në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar	PP, MD	Analiza e situates; Hartimi i masave për impementimin e gjetjeve		9 730			Në proces	Po diskutohet me projektet që mbështesin PP, për mundësinë e marrjes së ekspertëve të specializuar për kryerjen e një analize të situatës aktuale dhe kërkesave e standardeve ndërkombëtare të nevojshme. Pa kosto shtesë për PP.
8. Krijimi i infrastrukturës së nevojshme IT në DNJF	MD	Është dizajnuar sistemi i brendshëm i menaxhimit të rasteve/lendeve; Sistemi operativ i brendshëm i menaxhimit të rasteve		140 000			Në proces	AKSHI është drejt finalizimit të procesit të blerjes së pajisjeve hardware TIK të kërkuara nga DNJF. Gjatë muajit tetor 2019 do të dërgohen kontratat në mënyrë që të vijohet me levrimin e pajisjeve, sipas afateve të parashikuara në kontratë.
9. Përgatitja e një sistemi të integruar për publikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në Fletore Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, për publikimin e legjislacionit të përditësuar, të kodeve dhe të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave.	QBZ, AKSHI	Hartimi i termave të referencës, ndjekja e procedurave të prokurimit. Ndërtimi i sistemit, migrimi i të dhënave dhe testimi i sistemit. Implementimi i sistemit i gatshëm për përdoruesit; Ngritja e Korpusit të Legjislacionit të përditësuar.	69 840		10 000 (mijë lekë)		E realizuar	QBZ: Ndërtimi i sistemit të integruar për publikimin e ligjeve të konsoliduara dhe akteve nënligjore të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave (Arkiva Elektronike e QBZ) ka përfunduar në datë 29.03.2019 dhe është marrë në dorëzim nga specialistët e AKSHI-t. Tashmë është në funksion të plotë. Popullimi i sistemit me aktet ekzistuese për periudhën 2000-2018, si pjesë integrale e sistemit. Popullimi me aktet në vijueshmëri në faqen web të QBZ është proces i përditshëm i botimit në Fletoren Zyrtare. Menjëherë pas botimit të Fletores Zyrtare bëhet publikimi në kohë reale i akteve të ndara në faqen web të QBZ-së. Gjithashtu, bëhet publikimi i akteve të përditësuara dhe i përmbledhëseve të legjislacionit. AKSHI: Projekti për zhvillimin e sistemit të integruar të akteve ligjore dhe nënligjore në Fletoren Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, për publikimin e legjislacionit të

		Konsolidimi dhe përpunimi i sistemit midis QBZ dhe DPK; Përditësimi i legjislacionit.						<p>përditësuar, të kodeve dhe të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave, ka përfunduar implementimin në datë 29.03.2019, në zbatim të kontratës Nr. 2781, datë 14.06.18, si dhe amendimit Nr.750 prot, datë 13.2.2019, kontratë në të cilën bëjnë pjesë “Sistemi i arkivit të QBZ” si dhe ‘Mirëmbajtja e Printerit Xerox D136’.</p> <p>Projekti ka arritur objektivin e përgjithshëm të tij: Krijimin e Sistemit të Arkivës Elektronike të Akteve, që shërben për regjistrimin, editimin, publikimin, përditësimin, ruajtjen, administrimin dhe aksesimin e të gjithë akteve të botueshme në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar, politikat Kombëtare, standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikave më të mira në botë në këtë drejtim.</p> <p>Sistemi i akteve ligjore përmbush objektivat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikim elektronik të legjislacionit sipas formatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi; - Aksesim të shpejtë të statusit aktual të legjislacionit shqiptar; - Gjenerim të standardizuar dhe efektiv të informacionit në të gjithë fazat e tij; - Versionim dhe aksesim të lehtë të versioneve të dokumenteve; - Kërkim të shpejtë dhe efektiv të akteve ligjore përmes kërkimit të avancuar (me filtra specifik) si dhe kërkim në përmbajtje të tekstit, duke kërkuar me një fjalë ose me një të dhënë; - Rritjen e transparencës; - Rritjen e efikasitetit të punës së QBZ. Të gjitha proceset e punës të bazuara në kuadrin ligjor janë të informatizuara; - Paraqitje të akteve, bazat ligjore të
--	--	---	--	--	--	--	--	---

							<p>akteve, ndryshimet që ka pësuar akti në kohë, si dhe përditësim të aktit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Automatizim dhe kontroll të proceseve, krijimi, kontrolli dhe aprovimi i dokumentave, ruajtje, arkivim dhe ripërdorim të informacionit në trajtë dixhitale, në sistemin e brendshëm (DMS); - Migrimin e të dhënave për vitet 1999-2000, 2001-2018; - Korigjime dhe sistemime përsa i përket marrëdhënies së akteve në vijimësi. - Standardizim të publikimit të Legjislacionit Shqiptar në përshtatje me publikimin e legjislacionit të EU, ku më konkretisht përmendim indikatorin ELI (European Legislation Identifier), i cili ndër të tjera ofron një mundësi për të unifikuar dhe identifikuar në një formë të mirëpërcaktuar legjislacionin evropian online për të gjithë shtetet që e përbëjnë atë; - Ruajtje, arkivim dhe ripërdorim të informacionit në trajtë dixhitale; - Mundësi për shkëmbim informacioni elektronik të sigurtë dhe të kontrollueshëm mes QBZ dhe enteve gjeneruese të akteve; <p>Përsa më sipër, në bazë të kontratës sistemi dhe printeri Xerox D136 janë në fazën e mirëmbajtjes.</p> <p>MD: Në vijim të realizimit të kësaj mase, nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Drejtësisë po hartohet projektvendimi “Për miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Arkivit Elektronik të Akteve”. Në zbatim të Planit</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>Analistik të Projekt-akteve që do të paraqiten për miratim gjatë vitit 2019 i miratuar me VKM nr. 764, datë 27.12.2018, Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për propozimin e këtij projektvendimi.</p> <p>Projektvendimi ka si objekt miratimin e rregullave të hollësishme që kanë të bëjnë me mirëfunksionimin e Sistemit të Arkivës Elektronike të Akteve, që lidhen me regjistrimin, editimin, publikimin, përditësimin, ruajtjen, administrimin dhe aksesimin e të gjithë akteve të botueshme në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, politikat kombëtare, standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikave më të mira në botë në këtë drejtim.</p> <p>Projektvendimi pritet t'i përcillet për mendim Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe AKSHI-t e më pas dërgimin e tij për shqyrtim dhe miratim pranë KM.</p>
10. Përmirësimi i kapaciteteve infrastrukturore dhe institucionale të Arkivës Gjyqësore (ASHSGJ-së).	ASHSGJ	Hartimi i projekt zbatimit të "Rikonstruksion i ASHSGj-së". Rikonstruksion i ASHSGj-së (100%) dhe mobilim i pjesshëm i arkivit - rafte arkivore (46%)	51 000		1 339 (mijë lekë)		Në proces	Është hartuar projekti dhe likujduar në vlerën 1.339 mijë lekë. Rikonstruksioni i ambjenteve të ASHSGJ është në proces prokurimi.
11. Krijimi dhe funksionimi i sistemit elektronik të arkivës gjyqësore.	ASHSGJ	Krijimi i sistemit elektronik të arkivës (hardware e software).	28 800		0		Në proces	<p>Në proces vlerësimi për vijimësinë e kontratës për shkak të problematikave të konstatuara.</p> <p>Për këtë projekt, KLSH ka lënë rekomandimin: "Të revokohet kontrata e</p>

		Funksionimi i sistemit elektronik (hedhja e të dhënave)						shërbimit nr. 527/9 datë 26.05.2017 e cila nuk është efektive dhe efçente ku të gjitha hallkat e realizimit janë me performancë të ulët dhe sistemi i instaluar në ambientin test nuk mund të vlerësohet nga ana teknike, sepse aplikacioni nuk mund të përbëjë një sistem të plotë dhe funksional”.
<p><i>Aktualisht MD është në pritje të konkluzioneve që do të arrihen nga grupi i punës që është ngritur për analizimin e gjetjeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.</i></p>								

Objektivi 6: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit
Nën-objektivi 6/a: Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxhetimi / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
<p>1. Përfshirja e të burgosurve në aktivitete punësimi dhe rritja e numrit të aktiviteteve riintegruese:</p> <p>1.1 Përfshirja e të burgosurve në aktivitete punësimi.</p> <p>1.2 Ofrimi i kurseve të formimit profesional në aftësitë bazë dhe ato teknike.</p> <p>1.3 Ofrimi i programeve të tjera edukative, sportive,</p>	DPB	<p>Realizimi i kuadrit ligjor. Sqarimi i aspekteve ligjore së punësimit të burgosurve.</p> <p>Shtimi i numrit dhe llojit të kurseve profesionale për shtetasit e burgosur.</p> <p>Rritja e përfshirjes së shtetasve që frekuentojnë</p>		2 000			E realizuar	<p>1.1 Punësimi shihet si një komponent i rëndësishëm për procesin e ri-integrimit dhe rehabilitimit të personave me liri të kufizuar. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka ndërmarrë disa iniciativa për punësimin e të burgosurve dhe shfrytëzimin e kapaciteteve institucionale për edukimin e personave me liri të kufizuar nëpërmjet punës. Në zbatim të dispozitave ligjore punësimi i të burgosurve konsiderohet si mjet rehabilitues dhe jo ndëshkues. Është në zbatim një manual për stafet e edukimit për punën rehabilituese me personat me liri të kufizuar. Ndër të tjera, adreson çështjen e punësimit të burgosurve si një ndër komponentët bazë të punës ri-integruese dhe rehabilituese. Për periudhën janar-shtator 2019 janë punësuar mesatarisht në sistemin</p>

sociale dhe kulturore.		<p>procesin e formimit profesional në masën 10%.</p> <p>Rritja e pjesëmarrjes së shtetasve të privuar nga liria në këto aktivitete në masën 10%.</p>						<p>e burgjeve 649 të burgosur prej të cilëve: të paraburgosur 144 dhe të dënuar 505. Të burgosurit aktivizohen në aktivitete punësimi sipas mundësive që ofrojnë institucionet, kryesisht si mirëmbajtës, ndihmës kuzhinier, kopshtar, ndihmës në bibliotekë etj.</p> <p>Janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione lokale si Bashkia e Tiranës për të rritur mundësitë e ri-integrimit të personave me liri të kufizuar pas lirimit.</p> <p>1.2 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi kanë bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional për zhvillimin e procesit të formimit profesional në IEVP. Në zbatim të kësaj marrëveshje, procesi i formimit profesional është zhvilluar mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat fizike dhe bazën materiale që disponojnë institucionet, si dhe llojet e kurseve profesionale që ofrohen nga DRFP. Për periudhën janar-shtator 2019, kurset profesionale janë ofruar në 10 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 264 të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), pikturë, pirografi, elektrikist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldaturë.</p> <p>1.3 Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën gjatë një muaji aktivitete të tjera edukuese në të gjithë sistemin e burgjeve është 2876. Gjatë janar-shtator 2019 në IEVP janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 153 tema sociale në muaj dhe 29 recensione librash. Gjithashtu, janë zhvilluar 489 aktivitete ri-integruese. Është hartuar një dokument politikash për</p>
------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve sipas nevojave të tyre. Janë hartuar dhe vënë në zbatim programe edukuese për të burgosurit në prag lirim. Qëllimi i këtyre programeve është ri-integrimi i suksesshëm në shoqëri i të burgosurve dhe parandalimi i sjelljeve recidiviste. Këto kurse janë ndjekur nga 37 të burgosur.</p>
<p>2. Ulja e mbipopullimit në IEVP-të në përputhje me standardet evropiane.</p>	DPB	<p>Reduktimi i mbipopullimit me hapjen e burgut të Shkodrës në masën 3%.</p>	373 000				E realizuar	<p>Çështja e mbipopullimit në nivel të përgjithshëm në sistemin e burgjeve është një problematikë e zgjidhur. Kapacitetet totale të sistemit të burgjeve janë 6106 vende dhe gjatë janar-shtator 2019 janë trajtuar mesatarisht 5400 persona, prej të cilëve 258 shtetas me masë mjekësore mjekim i detyruar. Niveli i popullimit për periudhën janar-shtator 2019 ka qenë mesatarisht -11% (-680). Pra, sistemi i burgjeve në nivel të përgjithshëm ka qenë në kushtet e nënpopullimit.</p> <p>Eliminimi i mbipopullimit në burgje ka ardhur si rezultat i masave konkrete qoftë në investime, si hapja e burgut të ri në Shkodër, investim i Bashkimit Evropian dhe Qeverisë Shqiptare, si dhe ndërtimi i dy godinave të reja në IEVP Jordan Misja, Tiranë, investim i Qeverisë Shqiptare, ashtu edhe përmes kryerjes rast pas rasti të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe akomodimit të burgosurve në IEVP.</p>
<p>3. Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të të ndaluarve/ të burgosurve me probleme të shëndetit mendor.</p>	DPB	<p>Rikonstruksion godine për personat me probleme të shëndetit mendor me qëllim shndërrimin e ambienteve të</p>	62 629		22 825 (mijë lekë)		Në proces	<p>3.1 Është në fazën përfundimtare investimi për adaptimin e dy godinave në IEVP Lezhë në ambiente spitalore. Shërbimi shëndetësor në ambientet e reja spitalore për pacientët psikiatrikë mjeko-ligjore në IEVP Lezhë do të kalojë në administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Aspektet e angazhimeve reciproke në drejtim të trajtimit të kësaj kategorie në ambientet e reja spitalore në</p>

		<p>burgut në ambiente spitali.</p> <p>Përshtatja e një zgjidhje provizore për të ndaluarit/të burgosurit me probleme të shëndetit mendor;</p> <p>Ambiente rekreative dhe ndihmëse për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor;</p> <p>Paga konforme/uniform sipas standarteve për mjekët që punojnë në spitale dhe ato në burgje.</p>					<p>IEVP Lezhë do të përcaktohen në një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Administrimi i ambienteve të reja spitalore në IEVP Lezhë nga Ministria e Shëndetësisë do të mundësojë ofrimin e shërbimeve të specializuara për këtë kategori sipas protokolleve të MSH për krijimin e aksesit të këtyre pacientëve në aktivitete kuptimplota jashtë qelisë, kujdesin dhe kontaktin e nevojshëm njerëzor me specialistë të fushës (mjekë psikiatër, psikologë, kujdestarë etj).</p> <p>3.2 Duke marrë në konsideratë kërkesat e parashtruara të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për rritjen e pagave të mjekëve të cilët shërbejnë në sistemin e burgjeve me shkresën nr. 1825/1 datë 06.12.2018 Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka kthyer përgjigje që kërkesat shtesë për vitin 2019 në lidhje me këtë kërkesë nuk mund të miratohen. Gjithashtu, ka udhëzuar që kërkesat për rritjen e pagave të mjekëve të përfshihen në parashikimet e PBA 2020-2022. Me shkresën nr. 2058/1 datë 02.04.2019 Ministria e Drejtësisë, nisur nga ky fakt, ka udhëzuar gjithashtu, që kërkesa për rritjen e pagave të mjekëve të përfshihet në kërkesat buxhetore të DPB-së për vitin 2020-2022. Si rrjedhojë, është kryer parashikimi për rritjen e pagave të mjekëve, bashkë me koston financiare.</p>	
4. Garantimi i respektimit të të drejtave të të burgosurve	SHKBB	<p>Rishikim i kuadrit ligjor të fushës;</p> <p>Rritja e efikasitetit në trajtimin e ankesave të të</p>		35 000			Në proces	<p>MD: Në vijim të realizimit të kësaj mase dhe të zbatimit të VKM nr.746, datë 27.12.2018 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019” është parashikuar që të miratohet projektligji “Për funksionimin e kontrollit të brendshëm në</p>

		<p>burgosurve në masën 30 % në të gjitha institucionet penitenciare;</p> <p>Krijimi i databazave dhe identiteti digjital (web page-numër jeshil);</p> <p>Orientimi i ankesave në mënyrë më efikase dhe të drejtpërdrejte me strukturat përkatëse.</p>						<p>sistemin e burgjeve” dhe Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për propozimin e tij.</p> <p>Aktualisht Drejtorja e Hartimit të Legjislacionit ka hartuar projektligjin, i cili i është nështruar dhe procesit të konsultimit publik. Projektligji i është dëguar për mendim ministrive të linjës. Drafti është ripunuar në vijim të komenteve dhe është përcjellë për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave.</p> <p>SHKBB: Në lidhje me masën e dytë, trajtimi i ankesave të të burgosurve, familjarëve vazhdon me efikasitet të plotë nga sektori përkatës i hetimit dhe Ankesave.</p> <p>Në lidhje me masën e tretë, për periudhën Janar – Shtator 2019, përveç databazave të rrjetit të brendshëm, akoma nuk kanë filluar procedurat për krijimin e faqes web.</p>
--	--	---	--	--	--	--	--	---

Nën-objektivi 6/b: Përmirësimi i Shërbimit të Provës sipas standardeve evropiane dhe rritja e përdorimit të sanksioneve alternative

Indikatori / Treguesi:

% e vendimeve penale për krime që dënohen deri në 5 vjet, të cilat përfshijnë dënime alternative.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Përmirësimi i infrastrukturës së Shërbimit të Provës	Sh. i Provës	30 % e infrastrukturës së përmirësuar (zyrat); ofrim më i mirë i dënimeve alternative;	33 400		2 697 (mijë lekë)		E realizuar	<p>Gjatë periudhës janar-shtator 2019 janë sistemuar në ambiente me qera 8 Zyra vendore. Përmirësimi i infrastrukturës së Shërbimit të Provës ka arritur në masën 45%. Për më tepër kanë nisur dhe punimet në zgjerimin dhe rikostruksionin e Zyrave të DPSHP dhe ZVSHP Tiranë.</p> <p>Janë krijuar kushtet optimale në disa</p>

		22 persona të trajnuar.						ZVSHP në ofrimin më cilësor të mbikëqyrjes dhe përkujdesin e të dënuarve. Aktualisht stafi prej 25 punonjësish, i cili po trajnohet është i përshtirë në programin Suedez mbi Drejtësinë penale për të mitur. Programi aktualisht vazhdon trajnimin e punonjësve të shërbimit të provës. Gjithashtu, 2 punonjës janë trajnuar për paketën office, word excel etj. Fondet e shpenzuara për periudhën janar - shtator 2019 janë në shumën 2.697.285 lekë.
--	--	-------------------------	--	--	--	--	--	--

Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë

Nën-objektivi 7/a: Përmirësimi i procesit të hartimit të politikave, planifikimit dhe proceseve të vlerësimit të sistemit të drejtësisë

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e përealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Rritja e kapaciteteve planifikuese dhe monitoruese të Ministrisë së Drejtësisë me qëllim hartimin e politikave efikase mbi sistemin e drejtësisë dhe zbatimin e tyre.	MD, KM (asistues)	Identifikimi i nevojave për trajnim; Kalendar trajnimesh; Zbatimi sipas kalendarit të trajnimeve.	3 000				Në proces	MD: Për periudhën janar – qershor 2019 janë analizuar aktivitetet e draft dokumentit “TA Complementary support on SRC EU4Justice” dhe janë dhënë komente dhe sugjerime nga strukturat e MD-së dhe institucioneve përfituese me qëllim përfshirjen e aktiviteteve shtesë. Një nga këto aktivitete të parashikuara dhe të konkluduara edhe nga EUD është trajnimi i stafit të Sektorit të Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, në MD, si dhe strukturat e tjera relevante mbi përgatitjen dhe draftimin e Termave të referencës për Asistencën Teknike “TA Complementary support on SRC EU4Justice”, që pritet të

								<p>implementohet në Shkurt 2020 dhe me kohe zgjatje 34 muaj.</p> <p>Në vijim, dokumenti për Asistenca Teknike, pjesë e dokumentit IPA –AD nga “Kontrata Sektoriale e Drejtësisë me Mbështetje Buxhetore”, shuma prej 2,2 milion euro Asistencë Teknike “Mbështetje për zbatimin e kontratës sektoriale të Reformës në Drejtësi” është finalizuar me shkresë zyrtare drejtuar EUD-së.</p> <p>Për më tepër, më datë 8 mars 2019 me mbështetjen e EURALIUS është organizuar seminari me pjesëmarrje aktive për Zhvillimin e një Plani Zhvillimi të Kapacitetit Institucional të Ministrisë së Drejtësisë, ku morrën pjesë 35 nëpunës të MD-së.</p> <p>Gjithashtu, Drejtoria e Programeve në Fushën e Drejtësisë dhe Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve (në MD), në muajin qershor 2019 kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara në KM për përdorimin e sistemit IPSIS. Në këto trajnime morrën pjesë 4 nëpunës të Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>KM: Është zhvilluar një trajnim 5-ditor në kuadër të zhvillimit të sistemit IPSIS me qëllim njohjen dhe përdorimin e moduleve respektive kryesisht në kuadër të hartimit të politikave të kuadrit strategjik, strategjive sektoriale dhe prioritetëve të qeverisë, PKIE-së, planit analitik të projekt-akteve, si dhe zhvillimin e programeve dhe projekteve strategjike.</p> <p>Fokus i veçantë në modulet respektive u dha lidhur me pasaportat e indikatorëve, si dhe</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								kostimin e dokumentave politikë.
2. Krijimi i një sistemi për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator të legjislacionit	KM MD	Trajnime të vazhdueshme për punonjësit dhe për punonjësit e rekrutuar rishtazi.	1 500				E realizuar	<p>KM: Trajnimet e zhvilluara në këtë kuadër janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 7 Janar 2019 – Trajnim i kryer nga Njësia RIA, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë (DPRR) për punonjësit e institucioneve të varësisë së Kryeministrit për procesin e Vlerësimit të Ndikimit; • 21-22 Shkurt 2019 – Workshop-Trajnim për Ministrinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi përgatitjen e RIA-s. Trajnim i kryer për të rritur kapacitetet e ministrive dhe agjencive të varësisë në hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit, organizuar nga DPRR me mbështetjen e SIGMA-s. • 28-29 Mars 2019 – Vizitë Studimore mbi implementimin e RIA-s të organizuar në bashkëpunim me Presidencën e Këshillit të Ministrave të Italisë, Senatin dhe Shkollën Kombëtare Italiane të Administratës. • 2-3 Maj 2019 – Trajnimi për trajner mbi Modelin e Kostimit Standard, Faza 1. Trajnim i organizuar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës me mbështetjen e SIDA-s. • 16-17 maj 2019 - Klinikat e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator për Ministrinë e Linjës për çështjet teknike në raportet e RIA-s. Trajnim i kryer për të rritur kapacitetet e ministrive dhe agjencive, të organizuar nga DPRR me mbështetjen e SIGMA-s. • 13-14 Qershor – Trajnimi për trajner mbi Modelin e Kostimit Standard, Faza 2.

								<p>Trajnim i organizuar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës me mbështetjen e SIDA-s.</p> <ul style="list-style-type: none"> • 27-28 Qershor – Workshop i avancuar i RIA-s me ushtrime praktike për Rrjetin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator. Trajnim i kryer për të rritur kapacitetet e Ministrive të Linjës, organizuar nga DPRR me mbështetjen e SIGMA-s. <p>MD: Gjatë periudhës Janar-Shtator 2019, punonjësit e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit kanë qenë pjesëmarrës të trajnimeve të vazhdueshme për të rritur kapacitetet e ministrive dhe agjencive të varësisë në hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit, organizuar nga DPRR i Kryeministrit me mbështetjen e SIGMA-s.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

Nën-objektivi 7/b: Përmirësimi i kapaciteteve të hartimit dhe analizës ligjore dhe për njoftimin dhe konsultimin publik

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Përmirësimi i sistemit të njoftimit publik dhe konsultimit të legjislacionit	KM, MD	Trajnim: -për plotësimin e regjistrit të konsultimeve; - trajnim për proceset e njoftimit dhe konsultimit	2 400				Në proces	<p>KM: Në bashkëpunim me Sigma/OECD në muajin Korrik 2019 është zhvilluar një workshop me ministrinë e linjës në funksion të përmirësimit të procesit të konsultimit publik.</p> <p>Drejtorja e Politikave dhe Sistemeve për Mirëqeverisje në Kryeministri koordinon dhe monitoron kryerjen e procesit të konsultimit publik nga ana e institucioneve nga pikpamja e realizimit të cilësisë së këtij treguesi, si dhe të numrit të akteve që i nënshtrohen konsultimit publik.</p>

									<p>Për periudhën janar-shtator 2019 rezulton që Ministria e Drejtësisë ka përformuar në masën 100% në lidhje me numrin e akteve që i nënshtrohen konsultimit publik, me cilësinë maksimale 8 pikë sipas metodologjisë së aplikuar të vlerësimit të SIGMA-s.</p> <p>Nga aktet e miratuara objekt i konsultimit publik rezultojnë që vetëm 1 prej tyre ka qënë i parashikuar në Planin analitik Vjetor të Projektakteve dhe Planin Kombëtar për Integrim Evropian, 3 aktet e tjera janë jashtë këtyre dokumentave të planifikimit.</p> <p>MD: Në Ministrinë e Drejtësisë Koordinatori për Konsultimet Publike realizohet si detyrë nga specialist i Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit. Në përmbushje të detyrimit që buron nga "Udhërrëfytyesi për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile" 2018 – 2020, Koordinatori për Konsultimet Publike, në Ministrinë e Drejtësisë, ka marrë pjesë në trajnimin njëditor të datës 12 Qershor 2019 për "Konsultimin Publik" të organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, si dhe janë hartuar raportet 3-mujore dhe 6-mujore të konsultimit publik në përputhje me raportimet sektoriale.</p>
Nën-objektivi 7/c: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar sipas standardeve evropiane									
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019	
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë			

<p>1. Forcimi i kapaciteteve të MD për të përgatitur rregullimin e legjislacionit vendas sipas <i>acquis communautaire</i></p>	<p>MD</p>	<p>Rekrutim/shtim i numrit të punonjësve në njësinë e përafrimit të legjislacionit;</p> <p>Analizë e nevojës për të përcaktuar legjislacionin që do të përafrohet në bashkëpunim me strukturat e përmbytjes dhe institucionet e varësisë;</p> <p>Trajnime efektive që lidhen me proceset e përafrimit.</p>	<p>1 500</p>			<p>E realizuar</p>	<p>Miratimi i strukturës është realizuar me Urdhrin nr. 166/2017, me të cilin është krijuar Sektori i Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit.</p> <p>Në fund të muajit mars 2019 është plotësuar përkohësisht vendi vakant për një specialist, pranë Sektorit të Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit.</p> <p>Sa i takon vlerësimin të nevojave për trajnim, për periudhën shkurt 2019 është paraqitur kërkesë për trajnim, mbi teknikat e përafrimit, kurse gjuhe të huaj.</p> <p>Nga ana e ASPA-s është komunikuar aksesimi online, për përditësimin e njohurive në gjuhë të huaj.</p> <p>Në muajin Mars është zhvilluar një trajnim mbi përafrimin e legjislacionit evropian dhe teknikave të përafrimit, si dhe mënyrës se si plotësohet një LGA, ku nga Drejtoria e Kodifikimit kanë marrë pjesë 3 nëpunës.</p> <p>Për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit është organizuar një trajnim me Euralius, në datën 25-27 Qershor 2019, pranë ASPA-s me temë “Rritja e aftësive për të vlerësuar kushtetutshmërinë dhe pajtueshmërinë e projektligjeve me jurisprudencën e GJEDNJ dhe <i>acquis të BE</i>”.</p> <p>Për më tepër, në muajin Shkurt dhe në muajin Qershor, respektivisht në datat 18-20-21 Shkurt dhe 25-26 Qershor 2019, në bashkëpunim me ekspertët e misionit të EURALIUS-it është zhvilluar trajnimi për funksionarët publik të Ministrisë së Drejtësisë, të përfshirë në procesin pree-</p>
--	-----------	--	--------------	--	--	--------------------	---

							<p><i>screening për gjyqësorin, të drejtat e njeriut dhe anti-korrupsionin.</i> Pjesë e këtij takimi kanë qënë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë (Drejtoria e Kodifikimit dhe Hartimit të Legjislacionit, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë dhe anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian).</p>
<p>2. Rritja e kapaciteteve të departamentit të lidhur me donatorë të ndryshëm në MD.</p>	MD	<p>Identifikimi dhe konsolidimi i stafit të nevojshëm;</p> <p>Trajnime mbi menaxhimin e projekteve;</p> <p>Sistem elektronik për menaxhimin e punës së DKFP-së;</p> <p>Asistimi i ekspertit në procesin e departamentit</p>	28 500			Në proces	<p>Për periudhën janar - shtator 2019 janë kryer trajnime mbi menaxhimin e projekteve, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trajnim i organizuar nga ASPA me temë: “Evidentimi i rreziqeve të korrupsionit në Legjislacion” më datë 18 prill 2019. • Trajnim i financuar nga Bashkimi Evropian me temë: “Mbi aplikimin e prokurimeve kryesore IPA dhe procedurat e kontraktimit për shërbime, mallra dhe twinning dhe mbi menaxhimin e kontratave për mallrat dhe shërbimet”, organizuar nga asistenca teknike “Support to the Albanian System for indirect management with the beneficiary country”, më datë 22.05.2019. • Workshop mbi “kostimin e reformave strukturore në ERP, metodologjia dhe sfidat”, i organizuar më 28 maj 2019 nga CEF. • Trajnim i organizuar nga ASPA me temë: “Hartimi dhe menaxhimi i projekteve”, më datë 19-21 qershor 2019. • Trajnim i organizuar nga ASPA me temë: “Planifikimi strategjik”, më datë

								<p>2-3 korrik 2019.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trajnim i organizuar nga ASPA me temë: “Planifikimi Operacional”, më datë 25-26 korrik 2019. • Trajnim i organizuar nga asistenca teknike “Mbështetje për Menaxhimin IPA”, me temë: “Monitorimi dhe raportimi i projekteve”, më datë 26 shtator 2019.
Nën-objekti 7/d: Përmirësimi i funksionimit të MD dhe institucioneve të saj të varësisë								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019 - 2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Prgatitja e aplikantëve birësues mbi procesin e birësimit me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve.	KSHB	Zhvillimi i seancave të këshillimit të aplikantëve birësues në grupe të ndara; Këshillim për 30 cifte aplikantësh (takime informative mbi procedurat e birësimit/intervista me psikologë e punonjës socialë).	175 000		12.832 (mijë lekë)		Në proces	<p>Gjatë periudhës janar-shtator 2019, janë realizuar në total 6 (gjashtë) seanca këshillimi, gjatë të cilave janë trajnuar dhe informuar mbi procesin e birësimit 11 (njëmbëdhjetë) çifte aplikantësh për birësim.</p> <p>Buxheti i realizuar që i takon seancave të këshillimit të zhvilluara deri aktualisht është në masën 12 832 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë.</p> <p>Deri në përfundim të vitit 2019, parashikohet të realizohet objektivi i synuar për ofrimin e këshillimeve.</p>
2. Përmirësimi i legjislacionit të fushës së mjekësisë ligjore dhe akteve të tjera nënligjore.	IML	Përmirësimi i rregullores së brendshme mbi funksionimin e IML-së;	50		0	0	Në proces	<p>IML: Është dërguar propozimi për ndryshimin e rregullores në Ministrinë e Drejtësisë.</p> <p>Pas dërgimit të draftit të parë nga IML,</p>

		<p>Ndryshim i VKM, Nr.120, datë 27.2.2003 “Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore”;</p> <p>Rishikim i ligjit për Autopsinë;</p> <p>Draftim dhe miratim i ligjit mbi funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore;</p> <p>Përmirësimi i procedurës së betimit të ekspertëve në gjykatë (në KPrC)</p>						<p>aktualisht është në fazë vlerësimi drafti i rregullores së brendshme të IML-së, nga MD.</p> <p>Përsa i përket nën-masave të tjera janë ngritur grupet e punës për propozimet përkatëse.</p> <p>MD: Përsa i përket ndryshimeve të VKM Nr.120, datë 27.2.2003 “Për krijimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore”, rishikimin e ligjit për Autopsinë, hartimin dhe miratimin e një projektligji mbi funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, ato nuk janë të përfshira në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019, i miratuar me VKM nr. 764, datë 27.12.2018. Nga ana e tjetër, Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit, në MD, do të japë kontribut në të gjitha nismat që do ndërmerren për rishikimin e projektakteve të përmendura më sipër, pasi të paraqitet kërkesa e motivuar për ndryshime në legjislacion dhe pasi nevoja e ndërhyrjeve të jenë vlerësuar nga strukturat përgjegjëse për politikën që ndiqen për institucionet e varësisë.</p>
<p>2. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të IML nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës në IML, në ambientet spitalore (spitali QSUT) si dhe spitaleve në rrethe, në pajisje (laboratori ADN) dhe në stafin/personelin e</p>	IML	<p>Studim i praktikitetit mbi ndarjen e Zyrave Rajonale të Mjekësisë Ligjore & Spitaleve;</p> <p>Zbatimi i procedurave të dakorduara;</p>	12 040	255 000	8 191 (mijë lekë)	0	Në proces	<p>Janë ngritur grupet e punës për propozimet përkatëse.</p> <p>Është realizuar investimi në vlerën blerje për pajisje laboratorike (autopsi), si dhe është në proces rikonstruksion i ambienteve të brendshme të IML-së, për të cilën është lidhur kontrata për (punimet, kolauduesin dhe mbikqyrësin). Vlera totale e këtyre investimeve shkon në shumën 8.190.700 lekë.</p>

institucionit.		<p>Krijimi i ambjenteve për laboratorët dhe zyra të përshtatshme pune;</p> <p>Pajisje për 6 Institucione Rajonale të Mjekësisë Ligjore.</p> <p>Krijimi i ambjenteve dhe blerja e pajisjeve për laboratorin e ADN-së;</p> <p>Vlerësimi i kapaciteteve të institucionit dhe stafit.</p>						
4. Rishikimi i legjislacionit në lidhje me përmbarimin shtetëror	MD/DPP	<p>Propozimi për ndryshime në ligjin nr. 8730, datë 18.01.2001.</p> <p>Grup pune institucional për ndryshimet ligjore</p>	50		0	0	Në proces	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka ngritur grupin e punës për ndryshimet në ligjin nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të Përmbarimit”.</p> <p>MD: Rishikimi i ligjit “Për Përmbarimin Shtetëror” nuk është përfshirë në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019, i miratuar me VKM nr.764, datë 27.12.2018, por Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit, në MD, do të kontribuojë ndaj çdo nisme që do të ndërmerret për ndryshimin e ligjit “Për Përmbarimin Shtetëror”, pasi ai të jetë vlerësuar nevoja e ndërhyrjeve nga struktura</p>

								përgjegjëse për politikat që ndiqen për institucionet e varësisë.
5. Përmirësimi i infrastrukturës së godinave të shërbimit të përmbarimit shtetëror, infrastrukturës logjistike bashkëkohore (pajisje elektronike, pajisje zyre) dhe pajisja me automjete për kryerjen e detyrave me efektshmëri.	DPP	Identifikimi i projekt idesë për përmirësimin e ambjenteve të godinës së DPP dhe Zyrave Përmbarimore Tiranë, Fier, Korçë, Lushnje, Berat, Gjirokastrë, Krujë, Kukës, Lezhë, Mat, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tropojë, Dibër, Vlorë e Përmet. Evidentimi dhe përfshirja e projekt ideve në PBA; 45 % e infrastrukturës logjistike (pajisje elektronike) e përmirësuar;	47 000; 6 250; 2 750 (‘18); 10 000 (‘19); 8 000; 6 000 (‘20); 10 000; 4 000 (‘21)	550 000	10 000 (mijë lekë)		Në proces	Është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit publik “blerje pajisje elektronike” të planifikuar për vitin 2019, për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror duke mundësuar “blerje kompjutera, 30 copë”, “blerje skanera, 70 copë”, “blerje UPS, 6 copë”, “Blerje printer, 6 copë” si dhe “blerje switch, 10 copë). Gjithashtu, është në proces projekt ideja për përmirësimin e ambjenteve të Godinës së DPP-së dhe Zyrës Përmbarimore Tiranë.
6. Përmirësimi i burimeve njerëzore në këndvështrimin profesional operacional dhe financiar.	DPP	Vlerësimi i nevojave për trajnim; Identifikimi i nevojës për rishikim të trajtimit financiar të		50 500	0	0	Në proces	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit me evidentimin e nevojave për trajnim ka planifikuar dhe miratuar programin e trajnimit për përmbaruesit gjyqësore. Gjithashtu është në proces analiza e nevojës për shtesë të organikës së shërbimit dhe të rishikimit të trajtimit financiar.

		<p>punonjësve të shërbimit (rikategorizimi) ;</p> <p>Analizë e nevojës për shtesë të organikës së shërbimit.</p> <p>78 përmbaues gjyqësor të trajnuar;</p> <p>Evidentimi dhe përfshirja e projekt propozimit për rishikimin e trajtimit financiar në PBA.</p> <p>Evidentimi dhe përfshirja e projekt propozimit në PBA.</p>					
<p>Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin Nën-objektivi 8/a: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve të lira ligjore</p>							
<p>Indikatori / Treguesi: <i>% e inspektimeve për noterët të kryera nga Ministria e Drejtësisë</i></p>							
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxhetimi / Kosto¹⁹ (në mijë lekë) 2019 - 2021	Buxheti i shpenzuar për vitin 2019	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019	

¹⁹ * Buxhetimi i masave të profesioneve të lira ligjore do të mbulohet nga të ardhurat e vetë Dhomave, si ente private me vetëfinancim.

			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë	proces / e perealizuar)	
<p>1. Rritja e performancës së drejtorive përgjegjëse për monitorimin e profesioneve të lira ligjore dhe të institucioneve të varësisë në MD, nëpërmjet:</p> <p>1.1 Ngritja e një programi trajnimi për drejtorinë përgjegjëse për monitorimin e profesioneve të lira.</p> <p>1.2 Ngritja e një programi trajnimi për drejtorinë përgjegjëse për monitorimin e institucioneve të varësisë, veçanërisht me fokus kontrollin e respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata.</p>	MD	<p>Identifikimi dhe konsolidimi i stafit të nevojshëm për kryerjen e monitorimeve.</p> <p>Identifikimi i kurrikulave të trajnimit.</p> <p>Forcimi i sektorit përgjegjës për monitorimin e profesioneve të lira;</p> <p>Hartimi dhe miratimi i një liste të standardeve për zbatimin e kontrollit të noterisë;</p> <p>Hartimi dhe miratimi i një liste të standardeve për zbatimin e kontrollit të ndërmjetësve.</p> <p>Hartimi dhe miratimi i një metodologjie kontrolli të noterëve mbi</p>	8 900				Në proces	<p>Nga Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë, gjatë periudhës 17-30 shtator 2019, pranë ASPA-s kanë ndjekur trajnimin e detyrueshëm me temë “Prezantim me Administratën Publike” 3 specialistë.</p>

		<p>bazë risku.</p> <p>Hartimi dhe miratimi i një metodologjie kontrolli të ndërmjetësve mbi bazë risku.</p> <p>Forcimi i sektorit përgjegjës për monitorimin e institucioneve të varësisë nëpërmjet trajnimeve</p>						
<p>2.Rritja dhe forcimi profesional i avokatëve në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve nëpërmjet konsolidimit të programeve trajnuese të ofruara nga Shkolla e Avokatisë;</p> <p>Program i Edukimit Profesional të ofruar nga Shkolla e Avokatisë për trajnimin e avokatëve në mbarë vendin.</p>	<p>Shkolla e Avokatisë; Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë</p>	<p>Identifikimi i nevojave të trajnimit të avokatëve;</p> <p>Hartimi dhe miratimi i rregullores së trajnimit vazhdues;</p> <p>Miratimi i Planit 1-vjecar të trajnimit vazhdues të avokatëve bazuar në identifikimin e nevojave;</p> <p>Përgatitja e infrastrukturës së Shkollës së Avokatisë;</p>		7 000			<p>Në proces</p>	<p>Për konsolidimin e Edukimit Profesional të Avokatëve të cilën e ofron Shkolla e Avokatisë është punuar në dy drejtime kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përditësimi dhe forcimi i kurrikulave të trajnimit fillestar të asistent avokatëve/studentëve të Shkollës së Avokatisë në funksion të moduleve të bazuara mbi legjislacionin e veçantë të miratuar së fundmi sa i takon të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (të miturve, viktimave, KPP etj). 2. Ngritjen dhe konsolidimin e një programi të trajnimit vazhdues për avokatët e Shqipërisë. Përsa i përket zbatimit të programit të trajnimit vazhdues, DHASH ka filluar një bashkëpunim me Misionin Euralius V në hartimin e një Strategjie Afatmesme dhe afatgjatë në këtë drejtim. Pavarsisht kësaj, DHASH ka organizuar trajnime të ndryshme, kryesisht një cikël trajnimesh lidhur me temën e “Ankimit Individual Kushtetues” bazuar në ndryshimet

		Organizimi i 6 raundeve të para trajnuese						kushtetuese dhe ndryshimeve të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese” – në prill 2019; workshop me temë: “Sporteli i Dhomës së Arbitrazhit të Venecias në Shqipëri i bashkëorganizuar etj;
3. Ngritja e një programi specifik trajnimi për mbrojtjen e të drejtave të grupeve vulnerable veçanërisht për të miturit në konflikt me ligjin	Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë; Në bashkëpunim me Këshillin e Europës, etj.; Shkolla e Avokatisë	Analiza e nevojave për trajnim; Përgatitja e moduleve të trajnimit për të miturit në konflikt me ligjin; Organizimi i trajnimeve (raundeve të para për avokatët në gjithë Shqipërinë)		3 000			Në proces	<p>Ka përfunduar faza e identifikimit të nevojave për trajnim për avokatët kryesisht, si dhe ata që do të ofrojnë ndihmë juridike bazuar edhe në kërkesat e ligjit të ndihmës juridike apo ligjit për avokatinë për rritjen e cilësisë së shërbimit nga këta avokatë apo/edhe nevojën për të patur avokatë të specializuar, si psh për të miturit në konflikt me ligjin.</p> <p>Në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës u përgatitën dhe harmonizuan kurrikula mbi standardet e Drejtësisë Miqësore për të Miturit të trajtuara sëbashku me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit.</p> <p>Mbi bazën e këtyre kurrikulave është zhvilluar një trajnim intensiv online 3-mujor për 30 avokatë nga disa rajone të vendit. Lista e avokatëve të specializuar dhe modulet e trajnimit i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë.</p> <p>Raunde të tjera të trajnimit mbi KDPM janë parashikuar të zhvillohen në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare Terres des Hommes me të cilën është nënshkruar një MoU në mars 2019 lidhur me organizimin e trajnimit të avokatëve mbi drejtësinë restauruese, alternativat e dënimit, shmangien etj. <i>DHASH është në pritje të zbatimit të kësaj marrëveshje prej TDH.</i></p> <p>Në bashkëpunim me Barin Gjerman dhe Fondacionin IRZ është zhvilluar një trajnim</p>

							<p>me avokatët kryesisht dhe ata që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti mbi “Ndryshimet dhe risitë e Kodit të Procedurës Penale dhe standardet europiane” më datë 5 qershor 2019;</p> <p>Në datat 8-9-10 Korrik 2019 është zhvilluar sesioni i parë trajnues për avokatët kryesisht dhe avokatët e ndihmës juridike bazuar në programin praparak të trajnimit specifik/projekt pilot, i cili mbuloi tema si: parime të rëndësishme të procesit penal dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarit, sipas ndryshimeve të KPP; legjislacioni për ndihmen juridike, kush përfiton, cilat janë kategoritë e mbrojtura dhe të drejtat themelore të tyre; parimet dhe standardet e KEDNJ, si dhe GJEDNJ etj. Ky sesion trajnues u organizua në bashkëpunim me Organizatën TLAS në kuadër të Programit të përbashkët me Rjetin Ballkanik BRRLN.</p> <p>Për hartimin e një programi specifik trajnimi mbi të drejtat e grupeve vulnerabël për avokatët e ndihmës juridike dhe avokatët kryesisht do të bashkëpunohet me Rjetin Ballkanik BRRLN.</p>
<p>4. Ngritja e Qendrës së Trajnimeve për noterët në Republikën e Shqipërisë;</p> <p>4.1 Vlerësimi i noterëve sipas krediteve</p>	DHKN	<p>Ngritja dhe konstituimi i grupit të punës për të bërë të mundur funksionalizimin e Qendrës së trajnimeve;</p> <p>Hartimi i kurrikulave të trajnimit;</p>		1 400			E paraportuar

		<p>Ngritja e një programi për ngritjen e kapaciteteve të noterëve dhe kriteret e vlerësimit të tyre;</p> <p>Seanca trajnimi sipas programit të miratuar (gjithsej 4 seanca/vit);</p> <p>Vlerësim i noterëve.</p>					
<p>5. Krijimi dhe funksionimi i sistemit elektronik N.I.S.A., që siguron lidhje online në kohë reale të veprimtarisë së noterit me shërbimet publike.</p>	DHKN	<p>Dizenjimi i sistemit;</p> <p>Kryerja e procedurave të tenderimit;</p> <p>Testimi i sistemit për vënie në përdorim;</p> <p>Trajnimi i notereve për përdorimin e sistemit N.I.S.A.;</p>		1 072 800			E paraportuar
<p>6. Përmirësimi i kuadrit ligjor pas hyrjes në fuqi të ndryshimit të ligjit mbi ndërmjetësimin</p>	DHKNd	<p>Rishikimi dhe miratimi i akteve të Dhomës (Statuti; Kodi i Etikës);</p>		5 000			E paraportuar

		Rregullorja e Përgjithshme; Strategjia e DHKNd;					
7. Ngritja e Dhomave vendore dhe ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit; 7.1 Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve nëpërmjet organizimit të trajnimeve fillestarë, të vazhduar dhe gjithashtu trajnim i trajnerëve	DHKNd	Trajnim fillestar; Trajnimi vazhduar; Trajnim i trajnerëve; Miratimi i rregullave të funksionimit; Trajnim fillestar; Trajnimi vazhduar (30-50 ndërmjetës)		53 030			E paraportuar
8. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për shërbimin e ndërmjetësimit në vend	DHKNd	Media; Fletëpalosje dhe broshura; Fushatë informuese në shkolla dhe universitete; Takime me institucione publike dhe jopublike, notere, avokatë, jurisë dhe ekspertë		3 000			E paraportuar

<p>9. Finalizimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor në fuqi, që lidhen me organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor gjyqësor privat, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi.</p>	<p>MD, Kuvendi, DHKPGJP</p>	<p>Ndryshime ligjore që garantojnë:</p> <p>1-Adresimin e problematikave të ndeshura për shërbimin përbarimor gjyqësor privat, të evidentuara nga DHKPGJP dhe Ministria e Drejtësisë gjatë trajtimit të ankesave;</p> <p>2-Rregullimin e funksionimit të shoqërive përbarimore;</p> <p>3-Përcaktimit të detyrave të qarta të përbaruesve gjyqësorë privatë, për kryerjen e aktiviteteve që lidhen me natyrën e profesionit të tyre ligjor dhe rregullimit të mbledhjes me mirëkuptim të detyrimeve; njoftimit të palëve; mbajtjen e akt-</p>	<p>Pa kosto shtesë, pasi përballohet me kontributin e stafëve përkatëse të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës.</p>			<p>E realizuar</p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datën 08.05.2019 ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, i cili përmbylli edhe paketën e dytë të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë. Ky ligj ka për qëllim:</p> <p>a) adresimin e problematikave të evidentuar në analizën e sistemit të drejtësisë për shërbimin përbarimor gjyqësor privat;</p> <p>b) garantimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.</p> <p>c) hedhjen e bazave solide për zhvillimin e profesionit të përbaruesit gjyqësor dhe statusin e tij profesional, përgjegjësisë së tij ligjore, garancive të procesit përbarimor, marrëdhënieve institucionale, integritetit akademik të përbaruesve gjyqësorë në përputhje me standartet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.</p> <p>Nëpërmjet dekretit nr. 11195, datë 31.05.2019 Presidenti i Republikës vendosi kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit 26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”.</p> <p>Pas shqyrtimit të dekretit të Presidenti, Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 04.07.2019 vendosi rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës.</p> <p>Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 99, datë 10.07.2019.</p>
---	-------------------------------------	---	---	--	--	--------------------	--

		konstatimeve për dukuri, fakte dhe rrethana në ndihmë të aktivitetit gjyqësor apo mosmarrëveshje ve civile.					
<p>10. Forcimi i kapaciteteve profesionale të përmbaruesve gjyqësore privatë;</p> <p>10.1 planifikimi i trajnimeve sipas nevojave, mbështetur në analizën e ankesave dhe mangësive të konstatuara nga DHKPGJP dhe MD gjatë kontrollit dhe mbikëqyrjes së punës së përmbaruesve gjyqësorë privatë;</p> <p>10.2 Përgatitja e kurrikulave të trajnimit;</p> <p>10.3 Organizimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme (në varësi dhe të ndryshimeve ligjore);</p> <p>10.4 Përlllogaritje e kostove të funksionimit të qendrës së trajnimeve;</p>	DHKPGJP, MD	<p>(10.1) Evidentimi fushave dhe tematika më kryesore ku nevojitet zhvillimi i trajnimeve.</p> <p>(10.2) Përgatitja e kurrikulave të trajnimit.</p> <p>(10.3) Parashikim i qartë i numrit të orëve për trajnime vazhduese;</p> <p>Zhvillimi i të paktën 2 trajnimeve vazhduese gjatë vitit.</p> <p>(10.4) Kosto e përlllogaritur për ngritjen e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës</p>		7 000			E paraportuar

<p>10.5 Ngritjen e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.</p>		<p>Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.</p> <p>(10.5) Evidentimi dhe sigurimi i infrastrukturës mbështetëse për qendrën e trajnimeve pranë DHKPGJP;</p> <p>Struktura e miratuar për qendrën e trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë;</p> <p>Rregullore e miratuar mbi organizimin dhe funksionimin e qendrës së trajnimeve pranë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.</p>						
<p>11. Garantimi i procedurave të shpejta të ekzekutimit, përmes administrimit të informacionit.</p>	<p>DHKPGJP, MD</p>	<p>(11.1) Kryerja e një analize mbi nevojën e zgjerimit të aksesit në bazat</p>		<p>90 000</p>			<p>E paraportuar</p>	

<p>11.1 Kryerja e një analize mbi nevojën e zgjerimit të aksesit në bazat e të dhënave shtetërore të shërbimit përmbarimor gjyqësor;</p> <p>11.2 Nxitja e lidhjes së marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit;</p> <p>11.3 Ndërveprimi në kohë reale i sistemeve elektronike të shërbimit përmbarimor me sisteme të tjera shtetërore dhe baza të dhënash shtetërore dhe/ose me ente private.</p>		<p>e të dhënave shtetërore të shërbimit përmbarimor gjyqësor.</p> <p>(11.2) Marrëveshjeve të lidhura dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit.</p> <p>(11.3) Ndryshimet e nevojshme ligjore dhe teknike të realizuara, për ndërveprimin në kohë reale i sistemeve elektronike të shërbimit përmbarimor me sisteme të tjera shtetërore</p>						
---	--	--	--	--	--	--	--	--

		dhe baza të dhënash shtetërore dhe/ose me ente private.						
Nën-objektivi 8/b: Krijimi i një kuadri ligjor për arbitrazhin								
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Institucioni Përgjegjës	Targeti / Milestones 2019	Buxheti / Kosto (në mijë lekë) 2019-2021		Buxheti i shpenzuar për vitin 2019		Statusi i aktivitetit për periudhën janar-shtator 2019 (E realizuar / në proces / e parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar – shtator 2019
			PBA	Donatorë	Buxhet Shteti	Donatorë		
1. Hartimi i kuadrit ligjor vendas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike me arbitrazh.	MD, Kuvendi	Hartimi dhe miratimi i ligjit “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh” ; Miratimi i akteve nënligjore të parashikuara;	2 332				Në proces	<p>Roli i Kuvendit si në çdo nismë tjetër ligjore që paraqitet për shqyrtim dhe miratim është i lidhur me momentin e depozitimit të nismës nga Këshilli i Ministrave.</p> <p>Referuar Planit Analitik të Projekt-akteve të parashikuar për t'u miratuar me VKM nr. 764, datë 27.12.2018, është Ministria e Drejtësisë institucioni përgjegjës për propozimin e kësaj nisme ligjore brenda katërmujorit të tretë të vitit 2019.</p> <p>MD: Në zbatim të Planit Analitik të Projekt-akteve që do të paraqiten për miratim gjatë vitit 2019 i miratuar me VKM nr. 764, datë 27.12.2018, institucioni përgjegjës për propozimin e kësaj nisme ligjore brenda katërmujorit të tretë të vitit 2019 është Ministria e Drejtësisë.</p> <p>Aktualisht Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit është duke përgatitur draftin “Për Arbitrazhin”.</p> <p>Janë mbajtur takime me përfaqësues të Euralius të cilët kanë paraqitur edhe një draft për këtë projektligj. Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe</p>

								<p>Harmonizimit të Legjislacionit në datë 16.09.2019 ka zhvilluar një tryezë konsultimi me përfaqësues nga Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, Zyrat e Avokatisë, përfaqësues nga grupet e interesit dhe shoqëria civile. Ky takim ka patur për qëllim diskutimin e çështjeve që janë vlerësuar si thelbësore mbi politikën që duhet ndjekur dhe që duhet të reflektohen në projektligjin “Për Arbitrazhin”.</p> <p>Pasi Drejtorja e Hartimit të Legjislacionit të përgatisë draftin për “Arbitrazhin”, projektligji do t'i nënshtrohet konsultimit publik dhe do t'i përcillet për mendim ministrive të linjës dhe organeve të tjera të administratës publike, si dhe në përfundim dërgimin e projektligjit për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave brenda afateve të përcaktuara.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

DRAFT